

M A N U A L



**ROLI I MEDIAS  
NË RRUGËTIMIN  
E SHQIPËRISË DREJT  
BASHKIMIT EVROPIAN**

Titulli i manualit: **Roli i medias në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian**

Përgatitën për botim: **MSc. Ina Xhepa, MSc. Rildo Ngjela**

ISBN:

Ky manual u përgatit nga Qendra Europiane me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer, Zyra e Shqipërisë, në kuadër të projektit “Roli i medias në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian”.

Përmbajtja e këtij materiali, opinionet dhe vlerësimet e shprehura në të, janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjithë të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, e mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet ose përdoret me asnjë formë dhe mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**FONDACIONI QENDRA EUROPIANE**

Rr. Vaso Pasha,  
P. 20, Ap. 57  
Tiranë, Shqipëri  
[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)

**KONRAD-ADENAUER-STIFTUNG SHQIPËRI**

Blv. Dëshmorët e Kombit  
Kulla Binjake 1, Kati 11,  
Tiranë, Shqipëri  
[https:// www.kas.de/albanien](https://www.kas.de/albanien)

# ROLI I MEDIAS NË RRUGËTIMIN E SHQIPËRISË DREJT BASHKIMIT EVROPIAN

M A N U A L

Msc. Ina XHEPA

Msc. Rildo Ngjela

Tiranë, 2021



# TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie.....	7
Metodologjia.....	9
Shkurtime.....	11
<b>I. LIRIA E MEDIAS NË SHQIPËRI - PANORAMA HISTORIKE.....</b>	<b>13</b>
<b>II. KUADRI KUSHTETUES DHE LIGJOR PËR NJË MEDIA TË LIRË NË SHQIPËRI.....</b>	<b>21</b>
2.1 Liria e shprehjes dhe e medias si e drejtë kushtetuese dhe ligjore.....	21
2.2 Realiteti shqiptar – pozicioni i medias si rojtare e demokracisë.....	30
2.2.1 Qeverisja, organizimi dhe pozicioni i shtypit e medias në Shqipëri.....	30
2.2.2 Format e ndikimit dhe presionit në median shqiptare.....	38
2.2.3 Reklamat si mjet censurimi.....	57
<b>III. LIRIA E MEDIAS SI E DREJTË THEMELORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE</b>	
3.1 Këndvështrimi botëror – Organizata e Kombeve të Bashkuara.....	69
3.2 Këndvështrimi evropian.....	74
3.2.1 Legjislacioni dhe mekanizmat mbrojtës të Këshillit të Evropës.....	74
3.2.2 Kuadri rregullues i Bashkimit Evropian në lidhje me median.....	82
3.2.3 Standardet e OSBE.....	86
<b>IV. ROLI I MEDIAS NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN.....</b>	<b>88</b>
Bibliografia.....	101





## PARATHËNIE

Ky botim prezantohet në kuadër të Projektit “*Roli i medias në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian*”, realizuar me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer (KAS) Shqipëri përgjatë 2021.

Manuali **“Roli i medias në rrugëtimin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian”** është botimi i 5<sup>të</sup> i Qendrës Europiane në kuadër të një serie projektesh dhe botimesh për liritë dhe të drejtat të njeriut, të realizuar me mbështetjen e KAS Shqipëri.

Projekti synon, që të ofrojë panoramën e kuadrit normativ vendas, atij në nivel evropian dhe më tej global mbi lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim, me fokus specifik këtë herë tek liria e medias, duke iu drejtuar një audience, që synon të informohet dhe përditësojë njohuritë, mbi kategoritë

e lirive dhe të drejtave të njeriut të njohura e të garantuara nga shteti shqiptar.

Fokusi kryesor i botimit është realiteti shqiptar me zhvillimet legjislative dhe shoqërore në lidhje me median, statusi ligjor, qeverisja, pavarësia ose jo e saj dhe padiskutim roli thelbësor, që media luan në integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Një pjesë e manualit, që po ju prezantojmë përqendrohet tek kuadri normativ evropian dhe global, që në një masë të konsiderueshme është përthithur në kuadrin normativ vendas bazuar në proceset integruese dhe pjesëmarrëse të Shqipërisë ne organizata evropiane dhe botërore.

Manuali synon të gërshetojë trajtimet teorike me gjendjen aktuale në Shqipëri, që prej njohjes së medias së lirë, pas rënies së regjimit komunist e më tej në Kushtetutën e vitit 1998.

Përmes këtij botimi synojmë modestisht të plotësojmë kuadrin informativ dhe të zgjerojmë njohuritë mbi legjislacionin, institucionet dhe mekanizmat, që garantojnë dhe mbrojnë lirinë e medias në Shqipëri.





## METODOLOGJIA

Hartimi i këtij manuali u konceptua dhe mbështet në disa veprimtari kryesore të cilat do t'i shpjegojmë në vijim.

Fillimisht, nisi puna kërkimore për botime dhe artikuj me objekt lirinë e shprehjes, të drejtën për informim, lirinë e medias dhe organizimin e funksionimit të saj. Gjithashtu, u identifikua legjislacioni vendas mbi këto liri dhe të drejta.

Puna vijoi me përzgjedhjen e materialeve përkatëse burimore, akteve normative kombëtare e ndërkombëtare në lëmin e të drejtave të njeriut, duke u fokusuar specifikisht në temën qendrore të Manualit. Panorama mbi kuadrin ligjor vendas u pasurua me aktet normative europiane dhe botërore, si dhe me mekanizmat, që mbrojnë dhe garantojnë të drejt-

tat e parashikuara nga këto akte. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është një vlerë e shtuar për të kuptuar konkretisht garancitë ligjore në praktikë. Kjo praktikë pasqyron zhvillimet e fundit në fushën e mbrojtjes së gazetarëve dhe burimeve të tyre në përfitim të mirëfunksionimit të demokracisë.

Në pjesën e fundit të këtij Manuali është paraqitur rëndësia dhe roli i pazëvendësueshëm, që kanë gazetarët në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë. Natyrisht, fokusimi në kategorinë e përzgjedhura të lirive dhe të drejtave, konkretisht në lirinë e shprehjes, të drejtën për informim dhe lirinë e medias është e kuptueshme që ky material ka kufizime metodologjike. Synimi ynë kryesor është reagimi ndaj nevojës për plotësimin e kuadrit informativ me trajnime teorike dhe reflektime praktike mbi rëndësinë e lirisë së medias dhe rolit të pazëvendësueshëm të saj në Shqipëri.



## SHKURTIME

<b>AMA</b>	Autoriteti i Mediave Audiovizive
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
<b>GJEDNJ</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>GJK</b>	Gjykata Kushtetuese
<b>GJDBE</b>	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KEDNJ</b>	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
<b>KiE</b>	Këshilli i Evropës
<b>KM</b>	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

<b>Kushtetuta</b>	Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar
<b>Kuvendi</b>	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë
<b>OKB</b>	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>RTSh</b>	Radio Televizioni Publik Shqiptar



## LIRIA E MEDIAS NË SHQIPËRI - PANORAMA HISTORIKE

Liria e shprehjes, e drejta e publikut për informim dhe për rrjedhojë liria e medias përfaqësojnë tre prej të drejtave themelore më të rëndësishme për qytetarët, të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin e të drejtave të tjera të garantuara nga aktet ligjore kombëtare e ndërkombëtare. Marrja, shkëmbimi dhe përcjellja e informacionit janë gur themeli për funksionimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Kufizimi i këtyre të drejtave dhe lirive sjell pasoja të rënda në lidhje me të gjithë të drejtat e tjera themelore dhe jep mundësi për krijimin dhe/ose fuqizimin e autokracisë shtetërore<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Darbshire, H. et. Al. (1999). *Media and democracy*. Strasbourg: Council of Europe, p. 11-12.

Ndërsa, e drejta është një synim, kërkesë, nevojë ligjore, morale apo shoqërore, e cila ju njihet njerëzve; liria është e drejta për të jetuar individualisht dhe për të gëzuar të drejtat pa ndërhyrjen e shtetit. Për realizimin e një të drejte autoriteteve mund t'u lind nevoja për të marrë masa pozitive në një kohë, që në rastin e lirisë nuk ekziston një nevojë e tillë<sup>2</sup>.

Me qëllim krijimin e një konteksti të saktë mbi liritë dhe të drejtat objekt diskutimi në këtë manual do të ndalemi në përkufizimin e secilës prej tyre.

**Liria e shprehjes** është mundësia e një individi ose grupi individësh për të shprehur mendimin, besimin, idetë dhe emocionet pa u censuruar<sup>3</sup>. Në anën tjetër, **e drejta për informim** përfshin mundësinë e kërkimit, marrjes dhe dhënies së informatave të çdo lloji: verbalisht, me shkrim, përmes artit medias dhe teknologjive të reja<sup>4</sup>. **Liria e medias** nënkupton lirinë për të përdorur burime dhe metoda të ndryshme komunikimi me qëllim vendosjen në funksion të së drejtës për informim. Liria e medias tashmë përfshin

---

<sup>2</sup> Petrela, I. & Kodra, K. (2017). *E drejta për informim dhe liria e shprehjes: manual*. Tiranë: Qendra Europiane & KAS, f. 1-2.

<sup>3</sup> <https://www.freedomforuminstitute.org/about/faq/what-is-freedom-of-expression/> [konsultuar më 17.03.2021].

<sup>4</sup> Petrela, I. & Kodra, K. (2017). *Cituar më lart*, f.3.

jo vetëm shtypin e shkruar por edhe median audiovizive, elektronike dhe internetin<sup>5</sup>. Liria e shprehjes promovon respektimin e të drejtave të njeriut dhe mundëson sjelljen në vëmendje të shkeljeve potenciale të këtyre të drejtave përmes zërit të gazetarëve dhe aktivistëve<sup>6</sup>.

Në rrafshin historik shqiptar, liria e shprehjes, e drejta për informim, e për rrjedhojë dhe liria e medias nuk kanë pasur një rrugëtim të thjeshtë, duke qenë shumë shpesh objekt kufizimesh e censure.

Historiku i medias shqiptare, për shkak të një sërë faktorësh ndër të cilët dhe pushtimi osman, ka nisur vonë rreth mesit të shekullit të XIX me iniciativë të atdhetarëve shqiptarë, që jetonin jashtë vendit. Të dhënat e para të një gazete me origjinë shqiptare lidhen me Jeronim de Radën, i cili botoi gazetën shqiptare të shkruar në italisht “L`Albanese d`Italia”, në 1848. Ndërsa, më 25 mars 1897 u botuar revista “Albania” në gjuhën shqipe dhe frënge nga Faik Konica. Kjo revistë është konsideruar si një nga burimet

---

<sup>5</sup> <https://www.britannica.com/topic/media-freedom> [konsultuar më 17.03.2021].

<sup>6</sup> (...) Article 19. (2007). *Liria e shprehjes: standardet ndërkombëtare*. Tiranë: QSHDI, f. 9-10.

më të rëndësishme të shtypit të shkruar shqip<sup>7</sup>. Në fillim të shekullit të XX, pas nisjes së lëvizjes xhon-turke, nisën të botohen një sërë gazetash shqip brenda vendit. Numri i tyre nisi të shtohet veçanërisht pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912.

Pavarësisht nismave të ndërmarra nga atdhetarë e shoqata brenda e jashtë vendit, kuadri normativ për të rregulluar lirinë e fjalës dhe të shtypit në Shqipëri ka munguar deri në krijimin e mbretësisë së mbretit Zog I. Statuti Themeltar i Mbretërisë Shqiptare garantonte lirinë e fjalës dhe të shtypit, duke nguluar çdo formë censurimi. Sipas Statutit, kufizime të mundshme mbi këto liri mund të ndodhnin vetëm në rast lufte. Ndërkohë, që e drejta për të botuar gazeta në Shqipëri i jepej ekskluzivisht vetëm shtetasve shqiptarë<sup>8</sup>.

---

<sup>7</sup> Bebja, A. (2017). *Studim i rrallë dhe i veçantë francez mbi shtypin shqiptar 1848-1939*. <https://telegrafi.com/studim-rralle-francez-per-shtypin-shqiptar-te-viteve-1848-1939/> [konsultuar më 17.03.2021].

<sup>8</sup> Statuti i Mbretërisë Shqiptare, datë 1 dhjetor 1928, Artikulli 197 “*Liria e fjalës dhe e shtypit është e garantuar. Çensura parandaluese nuk mund të vihet, përveç në kohë lufte, mobilizimi dhe në raste të jashtëzakonshme të tjera të parashikuara prej ligjit. Kushtet mbi rregullimin e shtypit, konfiskimi i shtypshkrimeve dhe ndjekjet ligjore mbi gabimet e shtypit caktohen me ligj. Vetëm shtetasit shqiptarë mund të nxjerrin gazeta në Shqipëri.*”



Ligji i parë i posaçëm për organizimin dhe funksionimin e shtypit është miratuar gjatë po të njëjtës periudhë të mbretërisë më 24 janar 1931<sup>9</sup>. Ky ligj përbëhej nga 60 nene, të cilat më shumë se garantimi e rregullimi i lirisë së shtypit është vlerësuar si kufizues i saj, duke favorizuar vetëm ato medime që ishin pro qeverisë<sup>10</sup>. Gjatë të njëjtës periudhë qeverisëse në vitin 1937 u miratuan edhe dy dekrete të tjera, të cilat mbyllën disa gazeta, që publikonin informacione anti-regjimit.

Pak përpara pushtimit të vendit nga forcat fashiste, më 28 nëntor 1938, nisi punën stacioni i parë radiofonik në vend “Radio Tirana”.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve modeste nga ana ligjore e historike, gjatë kohës së pushtimit fashist u ndaluan dhe mbyllën të gjithë redaksitë e revistave e gazetave shqiptare, duke i hapur rrugë botimit të gazetës “Fashisti”, organ zyrtar i Partisë Fashiste në Shqipëri<sup>11</sup>.

---

<sup>9</sup> Ligja “Mbi shtypin”, datë 24.01.1931.

<sup>10</sup> Bebja, A. (2017). „Artikulllicituar. <https://telegrafi.com/studim-rralle-francez-per-shtypin-shqiptar-te-viteve-1848-1939/> [konsultuar më 17.03.2021].

<sup>11</sup> <http://albania.mon-rsf.org/sq/konteksti/historia> [konsultuar më 17.03.2021].

Më pas çlirimi i vendit dhe krijimi i qeverisë komuniste solli me vete botimin e 8 gazetave kombëtare, si dhe një sërë gazetash lokale. Ndër to mund të veçojmë si më të njohurat gazetat “Zëri i Popullit” dhe “Bashkimi”.

Kushtetuta e Republikës Popullore<sup>12</sup> e miratuar më 5 korrik 1950, pas shfuqizimit të Statutit të Republikës Popullore të 1946, garantonte të lirinë e fjalës dhe të shtypit për të gjithë shtetasit, duke i hapur rrugë të paktën në mënyrë formale shprehjes së fjalës së lirë dhe funksionimit të medias. Të njëjtën linjë mbajti dhe Kushtetuta e vitit 1976, e cila garantoi lirinë e fjalës për shtetasit, duke ndaluar çdo formë censure<sup>13</sup>. Ndërkohë, ky ligj parashikonte dhe ndërhyrjen e shtetit për formimin kulturor dhe ideologjik të “njeriut të ri”, duke vleftësuar kështu propagandën<sup>14</sup>. Radio dhe televizioni publik, ashtu

---

<sup>12</sup> Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 5 korrik 1950, neni 20 “*Të gjithë shtetasve u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e organizimit, e mbledhjes, grumbullimit dhe manifestimit publik.*”

<sup>13</sup> Ligj nr. 5506 datë 28.12.1976 “Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 53 “Shtetasit gëzojnë lirinë e fjalës, të shtypit, të organizimit, të grumbullimit, të mbledhjes dhe të manifestimit publik. Shteti garanton realizimin e këtyre lirive, krijon kushte për to dhe vë në dispozicion mejetet e nevojshme materiale.”

<sup>14</sup> Ibid, neni 32 “Shteti zhvillon një veprimtari të gjerë ideologjike e kulturore për edukimin komunist të punonjësve, për formimin e njeriut të ri. Shteti kujdeset në mënyrë të veçantë për zhvillimin dhe edukimin e gjithanshëm të brezit të ri në frymën e socializmit e të komunizmit.”

sikurse dhe media e shkruar gjatë periudhës komuniste ishin monopol shtetëror.

Panorama në aspektin formal tregon sikur gjatë periudhës komuniste u garantua liria e shprehjes e për rrjedhojë dhe liria për të marrë e dhënë informacion, por dispozitat e tjera ligjore sikurse ishin nenet e të dy Kodeve Penale të regjimit për veprën “agjitacion dhe propagandë”<sup>15</sup><sup>16</sup>, si dhe zbatimi i tyre në praktikë kanë treguar se gjatë kësaj periudhe mendimi, fjala dhe informacioni i lirë ishin të ndaluara.

Pas rënies së regjimit në vitin 1991, ligji tranzitor “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”<sup>17</sup>, garantoi

---

<sup>15</sup> Ligji nr. 1470, datë 23.5.1952 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 73 “Agjitacioni dhe propaganda kundër pushtetit popullor, agjitacioni dhe propaganda që përmbajnë thirrje për të minuar ose dobësuar pushtetin popullor si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e shkrimeve me përmbajtje e tillë, dënohen: me heqje të lirisë nga 3 gjer në 10 vjet me ose pa konfiskim të pasurisë. Kur këto vepra janë kryer në kohë lufte ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen: me heqje të lirisë jo me pak se 10 vjet ose me vdekje kurdoherë me konfiskim të pasurisë.”

<sup>16</sup> Ligji nr. 5591, datë 15.6.1977 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, neni 55 “Agjitacioni e propaganda fashiste, antidokratike, fetare, luftënxitëse, antisocialiste, si edhe përgatitja, përhapja ose ruajtja për përhapje e literaturës me përmbajtje të tillë për të dobësuar ose minuar shtetin e diktaturës së proletariatit, dënohet: -Me heqje të lirisë nga 3 gjer në 10 vjet.- Po këto vepra, kur janë kryer në kohë lufte ose kanë shkaktuar pasoja veçanërisht të rënda, dënohen: me heqje të lirisë jo më pak se 10 vjet ose me vdekje.

<sup>17</sup> Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”.

menjëherë lirinë e fjalës dhe të medias si një kusht i domosdoshëm për krijimin e demokracisë. Interesant mbetet fakti se vepra penale e “agjitacionit dhe propagandës” u shfuqizua në 1992<sup>18</sup>.

Në vijim do të trajtojmë parashikimin e kuadrit aktual kushtetues e ligjor për këto liri, duke pasur në fokus të veçantë lirinë e pavarësinë e medias.

---

<sup>18</sup> Ligji shfuqizues nr. 7553, datë 30.1.1992. <https://www.55news.al/dossier/item/191503-denimi-per-agjitacion-ne-vitet-1946-1992>



# KUADRI KUSHTETUES DHE LIGJOR PËR NJË MEDIA TË LIRË NË SHQIPËRI

## 2.1 Liria e shprehjes dhe e medias si e drejtë kushtetuese dhe ligjore

Liria e shprehjes, e drejta për informim dhe liria e medias janë të drejta të njohura dhe garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>, të cilat konsiderohen si gur themel i demokracisë në vendin tonë.

Pavarësisht se ekzistojnë shumë hapësira debati dhe burime informacioni, media dhe përcjellja e ngjarjeve prej saj përbën një element tepër të rëndësishëm të sferës publike. Roli i medias është i thelbësor sa i takon informimit të drejtë të qytet-

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar.

arëve, për ti mundësuar atyre pasjen e njohurive mbi sferën publike dhe qeverisjen. Media gëzon një sërë fuqish ndër të cilat mund të veçojmë përcjelljen e informacioneve në mënyrë të strukturuar, ndikimin në psikologjinë e njerëzve për shkak të besimit, që gëzon tradicionalisht, si dhe fuqi normative në bazë të parimeve të funksionimit të demokracisë e shtetit të së drejtës<sup>2</sup>.

Kategorizimi, që Kushtetuta i bën lirisë së shprehjes dhe medias, si dhe të drejtës për informim pasqyron qartë rëndësinë, që kanë këto të drejta dhe liri në sistemin tonë kushtetues. Ato renditen të dytat, menjëherë pas garancive për të drejtën e jetës, në Kreun II të Kushtetutës. Vendi i tyre në normën më të lartë në themel të shtetit shqiptar vjen edhe si pasojë e eksperiencës negative të kaluar nga qytetarët shqiptar përgjatë regjimit komunist. Mos ekzistenca e këtyre lirive do të shuante ekzistencën e demokracisë. Liria e shprehjes dhe e medias bën të mundur vendosjen në praktikë të të gjithë të drejtave të tjera duke denoncuar dhe rastet e shkeljes së tyre<sup>3</sup>.

---

<sup>2</sup> Darbshire, H. et. Al. (1999). *Media and democracy*. Strasbourg: Council of Europe, p. 13-14.

<sup>3</sup> Omari, L. & Anastasi, A. (2017). *E drejta Kushtetuese*. Tiranë: Dajti 2000, f. 115-116.

Konkretisht, **neni 22** i Kushtetutës garanton lirinë e shprehjes dhe të shtypit<sup>4</sup>. Në paragrafin e parë të tij garantohet liria e shprehjes, ndërsa në paragrafin e dytë ajo e medias në formën e saj të shkruar, si dhe audiovizive. Paragrafi i tretë i të njëjtit nen ndalon censurën paraprake të të gjitha mjeteve të komunikimit. Ndërkohë, **neni 23** garanton të drejtën e informimit<sup>5</sup>, duke mundësuar çdo individ për të dhënë e marrë informacion dhe për veprimtarinë e organeve shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të drejtat themelore, që po trajtojmë në këtë manual, lindin detyrime negative dhe pozitive për autoritetet shtetërore, me qëllim respektimin e frymës së Kushtetutës e ligjit. Kështu, në një rën anë shtetit i lind detyrim për t'i njohur këto të drejta dhe për të mos ndërhyrë në ushtrimin e tyre. Ndërkohë, në anën tjetër ai ka detyrim për të marrë të gjithë masat në mbrojtjen e qytetarëve nga ndërhyrjet në to. Kjo ga-

---

<sup>4</sup> Ibid, neni 22 “1. Liria e shprehjes është e garantuar. 2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. 3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet. 4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.”

<sup>5</sup> Ibid, neni 23 “1. E drejta e informimit është e garantuar. 2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. 3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

ranci parashikohet dhe në nenin 15<sup>6</sup> të Kushtetutës. Kufizimi i të drejtave kushtetuese, duke përfshirë këtu lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias mund të kryhet vetëm në përputhje me parashikimet e **nenit 17**<sup>7</sup>, nëse përmbushen në mënyrë kumulative të gjithë kushtet e vendosura. Kështu, duhet që kufizimi i këtyre të drejtave themelore të bëhet vetëm me ligj, në rastet kur ekziston një interes publik ose kur mbrohen të drejtat e të tjerë, duke respektuar gjithmonë parimin e proporcionalitetit. Duhet pasur kujdes pasi kufizimet e të drejtave themelore duhet të bëhen vetëm në ato raste kur janë të domosdoshme dhe nuk mund të ndërmerret ndonjë akt tjetër alternativ. Konventa Evropiane është në këtë rast i vetmi akt ndërkombëtar i thirrur në mënyrë eksplicite nga Kushtetuta si kufiri minimal, që duhet të zbatohet në respektimin e lirive dhe të drejtave themelore<sup>8</sup>.

---

<sup>6</sup> Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, neni 15 “1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.”

<sup>7</sup> Idib, neni 17 “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

<sup>8</sup> Paragrafi 2 i nenit 17.



Komunikimi mediatik bazohet mbi disa **parime** të rëndësishme të cilat janë: a) pluralizmi, b) objektiviteti, c) plotësia dhe d) paanshmëria. Nëse media nuk ushtron veprimtarinë e saj mbi këto parime, ajo le shkas për tu mos u konsideruar një burim i sigurtë informacioni për qytetarët. Nga ana tjetër e drejta për informim karakterizohet nga shumëllojshmëria e burimeve të informacionit dhe eliminimi i monopolit shtetëror<sup>9</sup>.

Përpos parashikimeve të shpjeguara më lart, liria e shprehjes dhe ajo e medias garantohe në sistemin tonë të brendshëm ligjor dhe nga një sërë aktesh ndërkombëtare, të cilat janë ratifikuar dhe bërë pjesë e legjislacionit tonë vendas, renditur menjëherë pas Kushtetutës, në përputhje me rregullimin për pozicionin e të drejtës ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme<sup>10</sup>. Ne do të ndalemi në analizën e tyre në momentin, që do të trajtojmë aktet ndërkombëtare dhe evropiane, që garantojnë këto liri.

Një akt tjetër tepër i rëndësishëm sa i takon integritet të vendit në Bashkimin Evropian (BE) është dhe Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), marrëveshje kuadër e cila parashikon hapat, që

---

<sup>9</sup> Omari, L. & Anastasi, A. (2017). *Cituar më lart*, f. 117 -121.

<sup>10</sup> Ibid, f. 51-53.

Shqipëria duhet të ndërmarrë në rrugën drejt anëtarësimit në BE. MSA referon Konventën Evropiane sa i takon garancive të lirisë së shprehjes dhe medias. Ndërkohë, detyrimet për përafrimin e legjislacionit të brendshëm në fushën audiovizive, si dhe fushën e shoqërisë së informacionit janë parashikuar në nenet 102-104 të marrëveshjes<sup>11</sup>.

Dispozita të tjera ligjore, të cilat lidhen me median, gjenden dhe në ligje të tjera të rëndësishme në fuqi në sistemin tonë. Kodi Civil lidh lirinë e fjalës dhe të medias me përgjegjësinë për dëmin jo pasuror, duke përcaktuar rastet kur caktohet shpërblim<sup>12</sup> për personin, si dhe mënyrën e caktimit të përgjegjësisë civile<sup>13</sup>.

---

<sup>11</sup> <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit> [konsultuar më 15.07.2021].

<sup>12</sup> Ligji nr. 7850, 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 625 Personi që pëson një dëm jopasuror ka të drejtë të shpërblehet kur: [...] b) është cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; c) është cenuar e drejta e emrit; ç) është cenuar respektimi i jetës private; [...].

<sup>13</sup> Ibid, neni 647/a “a) mënyrën, formën dhe kohën e përhapjes së thënieve apo kryerjes së veprimeve; b) shkallën e respektimit të rregullave të etikës profesionale nga autori i thënieve; c) format dhe shkallën e fajësisë; ç) faktin nëse thëniet kanë cituar apo referuar në mënyrë të saktë thëniet e një personi të tretë; d) faktin nëse thëniet janë të rreme, veçanërisht në rastin e cenimit të reputacionit; dh) faktin nëse thëniet kanë të bëjnë me çështje të jetës private të personit të dëmtuar dhe raportin e tyre me një interes publik; e) faktin nëse thëniet përbëjnë opinione ose thënie që përmbajnë vetëm pasaktësi faktike të parëndësishme; ë) faktin nëse thëniet kanë lidhje me çështje me interes publik, ose me persona në funksione shtetërore a kandidatë për zgjedhje; [...].

Në Kodin Penal<sup>14</sup> janë parashikuar një sërë nenesh, të cilat lidhen drejtpërdrejtë ose indirekt me lirinë e shprehjes dhe medias, si dhe me ushtrimin e profesionit të gazetarit. Këto nene kanë të bëjnë kryesisht me veprat penale të: fyerjes<sup>15</sup>, shpifjes, goditjes për shkak të detyrës, kanosjes për shkak të detyrës.

Duke u nisur nga rastet e publikuara në media por dhe me punën dhe pasojat e punës së gazetareve apo përfaqësuesve të tjerë të medias, nenet që implikojnë indirekt lirinë e shprehjes dhe medias kanë të bëjnë me veprat penale të: kanosjes, ndërhyrjes së padrejtë në jetën private<sup>16</sup>, përdjekjes, përhapjes së sekreteve vetjake, pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës; kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik; moszbatimi i masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë; pengimi dhe shkelja e fshehtësisë së korrespondencës; përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik; përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike; zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete, etj.

---

<sup>14</sup> Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>15</sup> Veprat penale të cituara në këtë paragraf parashikohen në Kodin Penal në renditje si vijon: neni 119, 120, 237, 238, 84, 121, 121/a, 122, 123, 236, 242/a, 255, 267, 293/a, 295/a.

<sup>16</sup> Ibid, neni 121.

Disa prej këtyre veprave sikurse është ajo e moszbatimit të masave të autoriteteve shtetërore gjatë gjendjes së masave të jashtëzakonshme apo gjatë gjendjes së epidemisë, si dhe mos përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik tek qytetarët, kanë qenë dy vepra të cilat janë lakuar së tepërmi në ambjentin mediatik shqiptar prej politikanëve dhe qeverisë, në kohën e tërmetit të vitit 2019, si dhe periudhës së karantinës për Covid-19<sup>17</sup>.

Një ligj tjetër mjaft i rëndësishëm, i cili parashikon disa dispozita në lidhje me lirinë e shprehjes dhe atë të medias, është Kodi Zgjedhor<sup>18</sup>. Ky kod përcakton një kuadër të qartë ligjor mbi mbulimin e fushatave zgjedhore nga subjektet mediatike, duke përcaktuar dhe rregulla strikte për minutazhin në dispozicion të secilit subjekt politik<sup>19</sup>.

Përveç legjislacionit të sipërcituar, i cili ka një fushë veprimi më të gjerë, ekzistojnë një sërë aktesh ligjore specifike, të njohura si *lex specialis*, që ga-

---

<sup>17</sup> <https://tpz.al/mos-perhapni-panik-per-qellime-politike-zv-ministrja-e-shendetesise-karantina-per-koronavirusin-ploteson-standartet>

<sup>18</sup> Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>19</sup> Ibid, nenet 77-85/1 “Fushata zgjedhore dhe media”.

rantojnë lirinë e medias dhe të shtypit. Këto ligje do të trajtojmë në vijim.

Ligji për komunikimet elektronike<sup>20</sup>, ka për qëllim promovimin e konkurrencës në komunikimet elektronike, duke garantuar shërbim në të gjithë territorin. Ligji për të drejtën e informimit<sup>21</sup> jep mundësi qytetarëve por edhe të gjithë mediave të kërkojnë informacione nga të gjithë organet publike në nivel qendror dhe vendor. I vetmi përjashtim, që bën ligji ka të bëjë me informacionet e klasifikuara. Ky ligj bën të mundur, që gazetarët të marrin dhe shkëmbejnë informacion me organet publike, me qëllim përcjelljen më pas të tij tek publiku. Ligjvënësi jo vetëm ka siguruar të drejtën e publikut dhe medias për të marrë e shkëmbyer informacion, por edhe mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve. Ligji aktual<sup>22</sup>, i cili është subjekt rishikimi thelbësor, përcakton rregulla për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale. Rregullat duhet të jenë në përputhje me kuadrin ligjor për të drejtat dhe liritë themelore.

---

<sup>20</sup> Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

<sup>21</sup> Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

<sup>22</sup> Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

## 2.2 Realiteti shqiptar – pozicioni i medias si rojtare e demokracisë

Në këtë seksion të manualit do të ndalemi të trajtojmë kuadrin ligjor dhe institucional të posaçëm, që rregullon organizimin dhe funksionimin e shtypit dhe medias audiovizive në Shqipëri. Gjithashtu, do të trajtojmë format e ndikimit në median shqiptare, si dhe përdorimi i reklamave si mjet censurimi. Natyrisht e gjithë kjo panoramë do të paraqitet në raport me lirinë dhe pavarësinë e medias, si mjete thelbësore për një qeverisje demokratike.

### 2.2.1 Qeverisja, organizimi dhe pozicioni i shtypit dhe medias në Shqipëri

Përveç të gjithë ligjeve të trajtuara më herët, të cilët parashikojnë në mënyrë direkte ose indirekte aspekte të caktuara të lirisë së shprehjes dhe asaj të medias, legjislacioni specifik i dedikuar shtypit të shkruar dhe medias audio-vizive në Shqipëri përbëhet nga ligji për shtypin<sup>23</sup> dhe ai për mediat audiovizive<sup>24</sup>.

<sup>23</sup> Ligji nr. 8239, datë 03.09.1997 “Për shtypin”, i ndryshuar.

<sup>24</sup> Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.20213 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Me qëllim fitimin e personalitetit juridik organet e shtypit periodik mjaftojnë të regjistrohen dhe menjëherë fitojnë personalitet juridik si organizata mediatike. Në këto raste ligji nuk kërkon ndonjë licencim të posaçëm. Kufizimi i lirisë së shtypit mund të bëhet vetëm në rastet e sekuestrimeve, ku qëllimi është ndalimi i përhapjes së informacioneve të paraqitura. Sekuestrimi nuk mund të ndodhë nëse nuk ekziston një vendim gjyqësor, që e legjitimon atë.

**Shembull:** Gjykata e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar vendosi më 18 prill 2021 sekuestrimin e të gjithë kompjuterëve dhe pajisjeve të punës të gazetës Lapsi.al, pas publikimit të të dhënave mbi data bazën personale të votuesve të Tiranës, nxjerrë potencialisht nga portali zyrtar qeveritar e-albania. Sekuestrimi kishte sipas gjykatës qëllim ndalimin e përhapjes së mëtejshme të informacioneve, si dhe mos dëmtimin e provave materiale. Përmes një kërkesë bazuar në Rregullin 39 të Rregullores, Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj të ndërmjetëm për çështjen *Shkullaku dhe të Tjerët k. Shqipërisë*<sup>25</sup>, urdhëroi Shqipërinë për heqjen e sekuestrimit nga të gjitha kompjuterët dhe serverët e tjerë të Lapsi.al. Gjykata theksoi dhe një

---

<sup>25</sup> *Shkullaku dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, kërkesa nr. 20204/21.

herë në këtë rast detyrimin e shtetit shqiptar për të zbatuar këtë vendim, në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjykata nënvizoi rëndësinë e shtypit të lirë dhe paprekshmërinë e tij.

Në anën tjetër ligji për mediat audiovizive vepron për transmetimet lineare, jo lineare dhe shërbimet mbështetëse të tyre. Në ndryshim nga shtypi i shkruar, fitimi i personalitetit juridik të mediave audiovizive kërkon një licencim të posaçëm dhe jo vetëm regjistrim në organet kompetente.

Veprimtaria dhe transmetimet audiovizive mbështeten mbi disa parime të rëndësishme, të cilat kanë synim të garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e saj. Kështu, kjo veprimtaria është e lirë, respekton të drejtën për informim, personalitetin dhe të drejtat themelore të njeriut, nuk mund të cenojë rendin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin; duhet të jetë objektive dhe e paanshme; duhet të garantojë të drejtën e qytetarëve për të marrë shërbime audiovizive<sup>26</sup>.

---

<sup>26</sup> Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4 § 1.



Parimet e ligjit ndalen dhe tek operatorët audioviziv, të cilët gjatë punës së tyre dhe transmetimeve duhet të kenë gjithmonë në fokus respektimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës për informim, sikurse dhe të gjithë të drejtave e lirive themelore të individëve, ruajtjen e sekretit gazetaresk, si dhe respektimin e jetës private të individëve<sup>27</sup>. Sa i takon parimit të fundit, praktika gjyqësore evropiane, por dhe ajo vendase kanë vendosur standardin e përdorimit të testit të proporcionalitetit lidhur me figurën/figurat, të cilave mund t'u jetë cenuar jeta private, si dhe rolin që këta persona mbajnë në shoqëri.

**Ofruesit e shërbimeve mediatike** ndahen në disa **kategori** bazuar në: a) formën e pronësisë mbi kapitalin - shërbime publike, tregtare ose jo tregtare; b) qëllimin e veprimtarisë – tokësore, satelitore, kabllore, ose në internet; dhe c) zonës së shpërndarjes së sinjalit të tyre – kombëtare, lokale ose ndërkufitare<sup>28</sup>.

Ligji përcakton një sërë detyrash për këta ofrues, ndër të cilat vlen të theksohet detyrimi për të paraqitur në mënyrë objektive dhe të paanshme lajmet e transmetuara, duke mbuluar kështu ngjarjet me rëndësi të

---

<sup>27</sup> Ibid, neni 4 § 2.

<sup>28</sup> Ibid, neni 31.

madhe për publikun, si edhe shmangien e anshmërisë politike gjatë transmetimit<sup>29</sup>. Në vijim do të sjellim shembuj konkret nga realiteti i medias në Shqipëri, të cilët pasqyrojnë situatën reale të paanshmërisë, ose anshmërisë së medias në vendin tonë.

Ndër parimet më të rëndësishme të ligjit, që po trajtojmë është dhe **sigurimi i pavarësisë mbi kontrollin editorial** për programacionin e medias. Ky parashikim sjell një vlerë të shtuar, të paktën nga pikëpamja ligjore, e cila thekson dhe njëherë rëndësinë e pavarësisë dhe paanësisë së organeve të medias ndaj hallkave të tjera të pushteteve dhe veçanërisht politikës<sup>30</sup>. Kërkesa për regjistrimin dhe funksionimin e mediave kombëtare si shoqëri aksionare, duke ndarë pronësinë nga administrimi, është një siguri shtesë për garantimin e pavarësisë editoriale, veçanërisht për kanalet e transmetimit me mbulim të gjerë territorial. Kjo kërkesë ligjore është theksuar edhe nga Gjykata Kushtetuese<sup>31</sup>, e cila ka vendosur se licencat për transmetimet audio dhe audiovizive kombëtare duhet tu jepen vetëm shoqërive aksionare. Ky rregullim ligjor dhe jurisprudencial garanton një pavarësi ndërmjet pronësisë dhe ad-

---

<sup>29</sup> Ibid, neni 33 dhe neni 46.

<sup>30</sup> Ibid, neni 46 § 3 (d).

<sup>31</sup> Gjykata Kushtetuese vendimi nr. 56/2016.

ministrimit në mediat kombëtare, ndarje e cila sjell si rrjedhojë një informim të pavarur e të paanshëm të qytetarëve.

Organizimi i mediave kombëtare si shoqëri aksionare pas sjell detyrimin e këtyre mediave për tu strukturuar dhe qeverisur në mënyrë të njëjtë me këto shoqëri kapitali. Sipas parashikimit të së drejtës tregtare, **shoqëritë aksionare** janë: shoqëri me ofertë publike ose private, kapitali i së cilave është i ndarë në aksione të nënshkruara nga themeluesit, ku këta të fundit nuk përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj të tretëve për veprimtarinë dhe detyrimet e shoqërisë<sup>32</sup>.

Qeverisja e korporatave është një koncept në evolucion, ashtu sikurse dhe vetë biznesi, e cila përfshin një sërë marrëdhëniesh mes menaxhmentit të kompanisë, këshillit mbikëqyrës dhe grupeve të drejtpërdrejta të interesit. Ajo paraqet një strukturë përmes së cilës përcaktohen objektivat e kompanisë, si dhe mjetet për monitorimin e arritjes së tyre<sup>33</sup>. Kështu, ky proces qeverisës, i cili në thelb

---

<sup>32</sup> Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

<sup>33</sup> G20/OECD Principles of Corporate Governance, 2015 <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264236882-en.pdf?expires=1638553664&id=id&accname=guest&checksum=2D10E8035C-F44A0DB0308485705531B8> [konsultuar më 20.11.2021].

lidhet me konceptin e funksionimit të shtetit të së drejtës, bazohet mbi disa parime kryesore ku pronësia ndahet nga administrimi. Këto **parime** janë: a) qeverisja brenda një kuadri ligjor efektiv, b) mbrojtja e të drejtave të aksionareve, c) trajtimi i barabartë i të gjithë aksionareve maxhoritar apo në minorancë, d) njohja e të drejtave të grupeve të interesit, e) parimi i transparencës, si dhe f) përgjegjësia e Këshillit Mbikëqyrës<sup>34</sup>.

Ndjekja dhe respektimi i këtyre parimeve nga media kombëtare, i jep një vlerë të shtuar pavarësisë së saj nga interesa të caktuara. Ligji parashikon në vazhdim se në rastin e medias **ndarja e pronësisë nga veprimtaria editoriale** duhet të monitorohet dhe nga organet kompetente rregullatore në fushën e mediave audiovizive përmes miratimit të *Kodit të Transmetimit*. Ligji mundëson ankimin në lidhje me programet e transmetuara nga mediat, në ato raste kur individët kanë pretendime se u është cenuar dinjiteti dhe reputacioni i tyre. Garancitë për pavarësinë dhe paanshmërinë trajtohen edhe në rastet e sponsorizimeve të transmetimeve të cak-

---

<sup>34</sup> Malltezi, A. (2011). *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare*, Tiranë: Media print, f. 188-194.

tuara. Pra, sponsorizimet nuk duhet të ndikojnë pavarësinë editoriale të asnjë rast<sup>35</sup>.

Në vazhdim të rregullimeve për mediat kombëtare private, legjislacioni parashikon edhe statusin e **Radio Televizionit Publik Shqiptar (RTSh)**, si një person juridik publik, qëllimi i të cilit është ti përgjigjet kërkesave të të gjithë popullatës, duke respektuar vlerat njerëzore e demokratike<sup>36</sup>.

Organi rregullator në fushën e mediave audiovizive është **Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA)**, i cili është institucioni i pavarur i krijuar me ligj<sup>37</sup>. Kryetari/rja dhe anëtarët e AMA zgjidhen nga Kuvendi pasi lista të jetë verifikuar nga komisioni përkatës parlamentar për çështjet e medias. Ndër funksionet kryesore të AMA-s është licencimi i operatorëve të medias audiovizive, garantimi i shumëllojshmërisë së informacioneve të ofruara, si dhe mbikëqyrja e respektimit të Kodit të Transmetimit prej operatorëve. Me qëllim realizimin e funksioneve të saj, AMA duhet të hartojë një strategji, e cila vjen në përputhje me parashikimet ligjore. Gjithashtu, ajo mund të kontrollojë veprimtarinë programatike,

---

<sup>35</sup> Ibid, neni 45.

<sup>36</sup> Ibid, neni 118.

<sup>37</sup> Organizimi dhe funksionimi i AMA-s si dhe detyrat e saj kryesore parashikohen në nenet 6-29 të ligjit.

teknike dhe organizative të ofruesve të shërbimeve audiovizive<sup>38</sup>. Funkcionet dhe rëndësia, që ky organ rregullator ka në lidhje me licencimin dhe ofrimin e shërbimeve audiovizive në Shqipëri, thekson edhe një herë domosdoshmërinë e pavarësisë së tij.

Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore realiteti i medias kombëtare [por edhe lokale] në vend vazhdon të mbetet ende kaotik, duke mos e ndarë kështu pronësinë e një shoqërie aksionare, sikurse është media kombëtare, nga administrimi i saj. Pjesa më e madhe e televizioneve kombëtare në Shqipëri identifikohen si produksion i aksionerit maxhoritar. Gjithsesi, në lidhje me këtë çështje do të ndalemi më gjatë në vijim.

### **2.2.2 Format e ndikimit dhe presionit në median shqiptare**

Në vendet e Evropës Lindore dhe në Shqipëri marrëdhënia mes medias dhe politikës rrjedh si rezultat i zhvillimeve historike e politike. Shqipëria, duke qenë një vend i shtypur nga regjimi komunist për 45 vite me rradhë, rrjedhimisht do të ndjente edhe pasojat e propagandës e ndikimit politik, që do të vijonin edhe pas rënies së sistemit. Qasja autoritariste ashtu si në periudhën e komunizmit ndi-

---

<sup>38</sup> Ibid, neni 78.

hej edhe në vitet 1994-1996, ku maxhoranca e kësaj periudhe arriti deri në dhunë fizike ndaj gazetarëve dhe burgosje ndaj politikanëve të opozitës. Represioni politik ndaj mediave e arriti kulmin në 2 mars të vitit 1997, kur u dogj redaksia e gazetës ‘Koha Jonë’.

Krijimi i televizioneve si Tv Klan dhe Top Channel, të cilat vijojnë të dominojnë tregun audioviziv edhe në ditët e sotme, ishte një lajm i mirë për historinë e medias shqiptare, por edhe një lajm i keq, pasi dy televizionet më të mëdha herë pas here më shumë se sa interesit publik i kanë shërbyer dy partive më të mëdha në vend: Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste.<sup>39</sup> Shërbimi ka qenë në një nivel më të lartë gjatë periudhës kur këto dy forca politike kanë pasur pushtet, ashtu siç evidentohet edhe sot ku të dyja këto televizione kanë një politikë editoriale që anon krah maxhorancës socialiste.

Zhvillimin e sektorit deri në ditët e sotme, studiues të medias dhe shkencave politike e shohin me faza të ndryshme, ku vitet **1990-1994** përbëjnë median nën ndikimin politik, **1994-1998** median si kërkesë sho-

---

<sup>39</sup> Reporter.al, *Fushata virtuale; mbulimi nga media online anon në favor të PS-së*. Linku: <https://www.reporter.al/fushata-virtuale-mbulimi-nga-media-online-anon-ne-favor-te-ps-se/>

qërore dhe domosdoshmëri për t'u informuar, ndërsa **pas vitit 1998** e deri në ditët e sotme si konsolidim të medias së shkruar dhe asaj audiovizive në përputhje me vetë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë.<sup>40</sup> Përgjatë këtyre fazave të zhvillimit të medias, ndikimi politik ka qenë i vazhdueshëm, ku përveç mediave private, Radio Televizioni Publik Shqiptar ka qenë media kryesore ku aktorët politikë, veçanërisht ata në pushtet, e kanë përdorur gjithnjë. Megjithëse sot ka një zbutje të kësaj tutele, pasi ky televizion nuk ka influencën e dikurshme në publik, ai mbetet pjesë e ndikimit politik. Ky ndikim vjen pasi megjithëse anëtarët e Këshillit Drejtues të RTSH-së mund të vijjnë nga sektori i shoqërisë civile, organizatat e gazetarëve apo bota akademike, sërish në fund vendimi për ta merret nga politikbërësit në Parlament.

Nën shembullin e përdorimit të transmetuesit publik, politikanët dhe qeveritarët shqiptarë kanë tentuar të ndikojnë dhe kanë ndikuar edhe te mediat private. Ndër goditjet e para të politikës ndaj një televizioni privat ka qenë ajo ndaj televizionit Shijak (ndër televizionet e para private, i krijuar më 25 dhjetor 1995) ku u bë një përpjekje e vazhdueshme

---

<sup>40</sup> Zguri, Rr. *Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri*, 2017. fq.14-15. Linku: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>



për ta mbyllur duke përdorur si pretekst mungesën e licencimit, ndërkohë “rregullimi ligjor për median audio-vizuale u miratua në vitin 1998 dhe autoriteti rregullator i kësaj fushe u ngrit vetëm në vitin 2000”.<sup>41</sup>

Ashtu sikurse mund të përmendim tentativën e mazhorancës së ish-kryeministrit Berisha, i cili përdori të gjitha sulmet dhe format e shantazhit për të mbyllur televizionin Top Channel. Përpjekja e politikës për të kapur dhe dominuar median, kryesisht televizionet nuk ka ndalur vetëm në këto raste. Shembulli më i freksët është sulmi i qeverisë dhe mbyllja e televizionit ‘Agon Channel’. Ky televizion hyri në tregun shqiptar në prill të vitit 2013, me pronar italian Francesco Becchettin u shndërrua në një kritik të madh të qeverisë. Si kundërpërgjigje qeveria e kryeministrit Rama urdhëroi mbylljen e tij në mënyrë krejt arbitrare dhe pasi prokuroria e Tiranës kishte nisur një hetim ndaj Becchettit dhe bashkëpunëtorëve të tij në biznes për pastrim parash dhe evazion fiskal përmes manovrave financiare, që shkojnë në dhjetra milionë euro.<sup>42</sup> Përplasja mes qeverisë dhe Becchet-

---

<sup>41</sup> Ibid, f.20

<sup>42</sup> Gazeta ‘Panorama’, 27 korrik 2015, “Zyrtarizohen akuzat për Becchetti-n: Pastrim parash dhe krijim të skemave mashtruese”. Linku: <http://www.panorama.com.al/prokuroria-zyrtarizon-akuzat-per-becchetti-n-pastrim-parash-dhe-krijim-teskemave-mashtruese/>

tit përfundoi në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe në Tribunalin e Arbitrazhit në Uashington. Becchetti fitoi gjyqin dhe tashmë taksapaguesit shqiptarë duhet t'i paguajnë pronarit të 'Agon Channel', 110 milionë euro për dëmin e shkaktuar nga qeveria e kryeministrit Rama.<sup>43</sup> Çështja në GJEDNJ është ende në pritje për gjykim.

Duhet theksuar fakti se eksperiencia sipërmarrëse e shumë pronarëve apo biznesmenëve nuk rrjedh nga fusha e medias, por nga sektorë të tjerë të ekonomisë, ku kryesisht mbizotërojnë sektori i ndërtimit dhe pasuritë e paluajtshme. Në këtë mënyrë, aktorë politikë veçanërisht ata, që zotërojnë pushtet fillojnë dhe hyjnë në lidhje me pronarët e mediave më të fuqishme në vend për t'u favorizuar prej tyre në edicionet informative, veçanërisht gjatë fushatave elektorale, apo kur qeveria mund të përfshihet nga skandalet. Nga ana tjetër, pronarët e mediave kanë përfitime financiare nga maxhorancat qeverisëse.

Këtë fenomen e ka theksuar në mënyrë specifike edhe Departamenti Amerikan i Shtetit në një raport mbi të drejtat e njeriut për vitin 2020: "*Pronarët kanë*

---

<sup>43</sup> Gazeta 'Mapo', 21 korrik 2021. "Unë fitova"/ Becchetti në aksion për 110 mln €, Denaj: Do ta paguajmë <https://gazetamapo.al/une-fitova-becchetti-ne-aksion-per-110-mln-e-denaj-do-ta-paguajme/>

*përdorur mediat e tyre për të favorizuar apo promovuar interesat e tyre së bashku me partitë politike. Shumica e pronarëve të stacioneve televizive private kanë përdorur përmbajtjen e trasnemtueseve të tyre për të influencuar në veprimet e qeverisë që favorizojnë bizneset e tyre. Ka raporte të besueshme se drejtues mediash kanë përdorur mediat e tyre për të goditur biznese të caktuara përmes kronikave, që disa herë ishin faktike, herë të tjera spekulative.”<sup>44</sup>*

Kjo marrëdhënie simbiotike e krijuar midis aktorëve politikë dhe pronarëve të medias ka pasoja mbi gazetarët dhe gazetarinë si profesion, si dhe për interesin e opinionit publik. Duke u gjendur përballë këtij raporti mes pronarëve të medias dhe aktorëve politikë, veçanërisht ata të veshur me pushtet, kryeredaktorët, redaktorët dhe gazetarët do të duhet t'i binden politikës editoriale të përcaktuar nga pronari i medias.

Megjithëse pavarësia editoriale garantohet në parim nga legjislacioni shqiptar, por ajo mbetet në letër sepse në praktikën e punës së përditshmet politika editoriale përcaktohet nga pronarët e me-

---

<sup>44</sup> Albania 2020 Human Rights Report, link: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/03/ALBANIA-2020-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>

dias dhe kushtëzohet nga lidhjet financiare që kanë këta pronarë me figura të ndryshme të politikës, biznesit apo sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, sikurse shpjeguem, Kushtetuta garanton lirinë e medias dhe ndalon çdo censurë paraprake të mjeteve të komunikimit masiv. Ligji për Mediat Audiovizive e parashikon lirinë e shprehjes dhe lirinë e operatorëve të mediave audiovizive si një nga parimet themelore për veprimtarinë e transmetimeve audiovizive.<sup>45</sup>

Pavarësisht këtyre dispozitave, kjo nuk i ka ndaluar aktorët politikë, qeveritarët dhe biznesmenët ta përdorin median për interesat e tyre personale. Madje një nga shembujt ekzemplarë të tranzicionit shqiptar është përdorimi i Radio Televizionit Shqiptar. Transmetuesi Publik ka hartuar një listë të detajuar rregullash dhe parimesh, në mënyrë që gazetarët dhe punonjësit e tjerë të kësaj medieje të mbrojnë dhe përforcojnë pavarësinë e tyre profesionale, por në fund të ditës është një nga mediat më të përdorura dhe keqpërdorura në funksion të politikës dhe që ka shërbyer si altoparlant propagande për çdo parti që ka ardhur në pushtet përgjatë 30 viteve të fundit. Efekti domino që ushtron politika

---

<sup>45</sup> Ligj nr. 97/2013 "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", neni 4, pika b. Linku: <https://www.ilo.org/dyn/natlex/docs/ELECTRONIC/99706/119118/F-1658809941/ALB-99706.pdf>

dhe pronarët e mediave tek gazetarët evidentohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit, teksa i referohet një sondazhi të kryer.

*“Një sondazh i kryer me 800 profesionistë të medias shqiptare, i publikuar në viti në 2019 ka gjetur se 62 për qind e të pyeturve mendojnë se në punën e tyre ndërhyjnë individë të ndryshëm ose njerëz të politikës. 60 për qind mendojnë se në punën e tyre ndërhyjnë vetë drejtuesit e medias, 39 për qind theksojnë se vetëcensurohen dhe 31 për qind vënë në dukje se ndërhyrja ndodh pasi media është e korruptuar. Rreth 78 për qind e profesionistëve të medias mendojnë se ka gazetarë që janë të lidhur me praktika korruptive për të mos raportuar ngjarje të caktuara.”<sup>46</sup>*

Presioni që ushtrohet nga aktorët politikë së bashku me pronarët e mediave bëjnë që gazetarët të jenë tejet të brishtë dhe të pambrojtur në profesionin e tyre, veçanërisht në raportimin e saktë e të paanshëm. Ata janë të brishtë brenda strukturave të tyre mediatike sepse nuk kanë një politikë editoriale të formalizuar ku mund të vendosë bordi mediatik

---

<sup>46</sup> Albania 2020 Human Rights Report, link: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/03/ALBANIA-2020-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>, Fq.10

dhe jo pronari, kanë kontrata pune formale, të cilat në shumicën e rasteve favorizojnë pronarët dhe jo gazetarët. Duke u ndodhur në këtë situatë shumë gazetarë janë pushuar nga puna dhe janë sulmuar fizikisht. Largimet nga puna përfshijnë edhe emra të njohur të medias dhe gazetarisë shqiptare, pasi për reporterët është gati një praktikë e zakonshme që ndodh në media. Dy rastet e fundit ku politika ndërhyri direkt te pronarët e mediave kanë të bëjnë me largimin nga puna të dy moderatorëve, Ylli Rakipi dhe Adi Krasta nga televizioni News 24. Të dy gazetarët ishin tejet kritik me qeverinë e kryeministrit Rama. Ngjarja u pasqyrua si vijon:

*“Adi Krasta dhe Ylli Rakipi, dy gazetarë dhe kritikë të njohur të kryeministrit Rama, Partisë Socialiste dhe kryebashkiakut Veliq, janë hequr nga puna dhe programet e tyre në televizionin Neës24 janë mbyllur. Burime të ndryshme kanë raportuar se Krasta e humbi vendin e punës pasi pronari i Neës24, Irfan Hysenbelliu u vu nën presion nga Kryeministri Rama dhe Kryetari i Bashkisë Veliq.”<sup>47</sup>* Të dyja këto raste kanë nxjerrë në pah pushtetin e madh të ekzekutiv-it, i cili vendos të largojë nga puna gazetarët që janë kritik ndaj tij apo nuk i konvenojnë interesave të tij

---

<sup>47</sup> <https://exit.al/news24-mbyll-emisionet-e-krastes-dhe-rakipit-dy-nga-zerat-publike-me-kritike-ndaj-qeverise/>

dhe pronarëve të medias. Ndërthurja e interesave të tilla midis qeverisë dhe pronarëve është një goditje për vetë demokracinë, lirinë e shprehjes dhe gazetarinë shqiptar.

Duke iu referuar një sërë rastesh të represionit qeveritar, krimin të organizuar dhe aktorëve të tjerë ndaj gazetarëve, Freedom House në raportin për vitin 2020 e cilëson Shqipërinë një regjim hibrid, që vazhdon të humbasë pikë sa i përket demokracisë. Sipas këtij raporti, *“Pavarësia e media ka humbur pikë nga 3.75 në 3.50, duke reflektuar retorikë agresive të politikanëve apo njerëzve me pushtet ekonomik (oligarkët) ndaj gazetarëve duke i ‘përndjekur’ dhe intimiduar ata për përhapje të panikut (gjatë pandemisë). Si rezultat i kësaj demokracia në Shqipëri ka humbur pikë nga 3.82 në 3.75”*<sup>48</sup>

Nën presionin qeveritar janë gjendur edhe gazetarët e huaj që punojnë në Shqipëri. Një nga këto raste është ai i gazetares angeleze Alice Elizabeth Taylor. Pas qëndrimeve të saj kritike ndaj qeverisë në median online Exit.al dhe prononcimeve kritike për televizionin rus “Russia Today”, autoritetet shqiptare i refuzun rinovimin e lejes së qëndrimit.

---

<sup>48</sup> Raportii FreedomHouse për vitin 2020, linku: [https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4\\_u30q7pu](https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4_u30q7pu)

Asaj iu kërkua të largohej kur ndodhej në muajin e 6 të shtatëzanisë me fëmijën e të fejuarit të saj shqiptar. *“Qeveria shqiptare, pasi më ka sulmuar mua dhe partnerin tim për shkak të punës sime si gazetar dhe kritikant e mia ndaj tyre, tani kanë anuluar rinovimin e lejes sime të qëndrimit. Kështu që tani jam këtu në mënyrë të paligjshme dhe kërkohet të largohem, pavarësisht se kam një certifikatë mjekësore duke thënë se nuk mund të udhëtoj për shkak të komplikimeve që dalin nga të qenit gati 6 muaj shtatzënë. Me një fëmijë shqiptarë”* – shkruante gazetarja Taylor në marsin e 2019-s. Megjithatë, pas 8 muajsh betejë me autoritetet shqiptare, gazetares britanike iu pranua rinovimi i lejes së qëndrimit.<sup>49</sup>

Pavarësisht raporteve të institucioneve ndërkombëtare dhe thirrjes të tyre për të mos ushtruar presion ndaj medias, qeveria dhe aktorët e tjerë politikë e lokalë përpiqen të gjejnë rrugë të tjera të ndikimit politik në media. Një nga këto teknika është ajo e përgatitjes së kronikës televizive apo materialit të njoftimit për shtyp me ‘parametrat gazetareskë’. Kjo praktikë nisi të përdoret kryesisht në zgjedhjet e vitit 2009, për t’u fuqizuar në zgjedhjet lokale të vitit 2011, zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2013 e deri

---

<sup>49</sup> <https://www.reporter.al/gazetarja-alice-taylor-fiton-betejen-8-mujore-me-policine-e-shtetit/>



më sot që sa vjen edhe sofistikohet. Në zgjedhjet e vitit 2009, 2011, 2013 e më pas, partitë politike nuk lejonin gazetarët në terren për të mbuluar fushatën elektorale, por zyra e shtypit përgatiste kronikën e fushatës elektorale dhe ua dërgonite atë redaksive të lajmeve, të cilat e transmetonin të gatshme ashtu siç u vinte. Kjo krijoi precedentin, ku aktorët politikë ishin edhe drejtues, edhe kryeredaktorë të mediave duke përcaktuar përmbajtjen që do të transmetohej. Në këtë mënyrë, ndikimi politik ishte i drejtëpërdrejtë dhe mesazhi shkonte te qytetarët i pafiltruuar dhe krejtësisht në formën e propagandës së partive politike. Kjo ishte përcaktuar që më parë në lidhjen mes drejtuesve të partive politike dhe pronarëve. Ky fenomen ka vijuar edhe pas fushatave elektorale ku propaganda politike gjen vend në krye të listës së edicioneve të lajmve, veçanërisht nga dy televizionet më të mëdha, Top Channel dhe Tv Klan.

*“PS është e pranishme në Top Channel në 3 nga 30 edicione lajmesh kurse PD në 6 të tilla. Kurse në TV Klan, PS është e pranishme në 7 nga 30 edicione lajmesh kurse PD në 2 të tilla. Theksojmë se në muajt Shkurt-Mars kur është kryer monitorimi, ishte në zhvillim e sipër edhe protesta e PD e njohur si “protesta e çadrës”. Nga të dhënat duket se Top Channel është më i hapur për kasetat e PD se sa Klan TV, ndërkohë*

*që Klan TV është më i hapur për kasetat e PS se sa Top Channel.”<sup>50</sup>*

Fenemoni i ‘kasetave të gatshme’, është shndërruar në një formë tjetër të marketingut politik, edhe pse praktika mbetet e njëjtë. Madje tentativa për t’iu imponuar medias ka arritur deri në atë pikë sa kryeministri Edi Rama hapi në mars të vitit 2017, kanalën e tij në rrjetin social në Facebook, të quajtur ERTV duke ‘punësuar’ edhe ‘gazetarë’, ndërsa videot e tij janë transmetuar vazhdimisht nga televizionet, po ashtu edhe media online. Përgjatë vitit të fundit, kryeministri i transmeton videot e tij pa logon e ERTV-së. Megjithatë, aktorët politikë, ata në qeveri, në opozitë apo në krye të qeverisjes vendore tentojnë të vendosin agjendën politike mbi atë të medias. Kjo agjendë nis që me prodhimin e lajmeve përmes publikimeve të aktorëve politikë në rrjetet sociale. Më pas zyra e shtypit të qeverisë apo bashkisë përpunon materialet e akvitetëve të realizuara gjatë ditës, i bën ato gati për mediat, duke ua dërguar gazetarëve materialin përmes emailit dhe janë gati për transmetim apo publikim.

---

<sup>50</sup> Zguri, Rrapo. *Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri*, 2017. Fq.42-43. Linku: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>

Përveç qeverisë një nga aktorët politikë që e ka shndërruar në praktikë ‘kasetat e gatshme’ është edhe kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj. *“...një trend i ri për këtë institucion, i iniciuar nga kryetari aktual i Bashkisë së Tiranës qysh me zgjedhjen e tij në këtë post. Nga 30 edicione të lajmeve në Top Channel, Bashkia Tiranë ishte e pranishme me “kasetat të gatshme” në 23 prej tyre (ose në 77 % të tyre) kurse në TV Klan, Bashkia Tiranë ishte e pranishme me “kasetat të gatshme” në 24 nga 30 edicione lajmesh (ose në 80 % të tyre)”*<sup>51</sup>. Të dhënat e mësipërme janë shqetësuese pasi tregojnë një dominim të aktorëve politikë në dy televizionet më të mëdha në vend, të cilat kanë po ashtu një influencë të madhe në opinionin publik. Shumica e përmbatjes politike që transmetojnë këto televizione janë aktivitete politike të kryeministrit Rama dhe të kryebashkiakut Veliaj që nuk përbëjnë asnjë interes për opinionin publik, veçse për elektoratin e këtyre dy aktorëve politikë. Përveç televizionit, i cili mbetet një medium me një ndikim të madh në shoqërinë shqiptare, politika ndikon edhe në mediat online, të cilat rritur në mënyrë galopante vitet e fundit, numri i tyre shkon në 700 të tilla. Duke përdorur teknologjinë dhe fuqizimin e rrjeteve sociale, aktorët politikë synojnë të kapin jo vetëm audiencën e tyre të bindur që është pjesë e

---

<sup>51</sup> Ibid.

rrjeteve sociale, por edhe zërat kundër, qofshin këto në mediat online apo ato audiovizive.

Kjo mund të shihet si një përpjekje e qeverisë dhe bashkisë së Tiranës për të ndikuar median dhe opinionin publik përmes këtyre materialeve, të cilat në thelb janë njoftime për shtyp apo aktivitete politike, por që në mediat të cilat iu japin hapësirë ato publikohen të kamufluara në formën e lajmit, pa u edituar apo filtruar më parë. Ky fenomen evidënohet edhe nga monitorimi i 30 televizioneve dhe portaleve nga Qendra MediaLook në periudhën mars-maj 2108. “Nga monitorimi rezulton se artikujt apo kronikat e transmetuara gjatë kësaj periudhe në faqet online të televizioneve kombëtare në transmetimet dixhitale, Top Channel e TV Klan, në mbi 65% të përmbajtjes së tyre në tekst përputhen me njoftimin e dërguar nga zyra e PR-it të Bashkisë së Tiranës. Ndërsa në televizionin Vizion Plus ngjashmëria rezulton të jetë 58% (tekst + sinkron i zbardhur). Nga vëzhgimi është vërejtur se një pjesë e konsiderueshme e fotove dhe videove të transmetuara në këto ekrane kanë qenë të ngjashme me ato të shpërndara nga Bashkia Tiranë.”<sup>52</sup> Përveç

---

<sup>52</sup> *Televizionet, gazetat e portalet online “në shërbim” të Bashkisë Tiranë.* Linku: <https://www.medialook.al/televizionet-gazetat-dhe-portalet-online-ne-sherbim-te-bashkise-tirane/> [konsultuar më 22.11.2021]

ndikimit në televizionet kryesore siç u evidentua edhe më lart nga dy monitorimet e viteve të fundit, një përpjekje e madhe e aktorëve politikë bëhet për të ndikuar edhe në portalet apo mediat online më të klikuara “... ngjashmëria e lajmeve të publikuara nga faqja [www.panorama.com.al](http://www.panorama.com.al) me njoftimet në faqen e Bashkisë së Tiranës është 86.4%. Mesatarja e përputhshmërisë mes lajmeve të Balkanweb dhe njoftimit të Bashkisë Tiranë ishte 93%. ...Tema Online, ku mesatarja e përputhshmërisë përgjatë 15 ditëve të vëzhguara rezultoi të jetë 82.1%. Portalet që plotësojnë listën e dhjetë mediave që publikojnë lajme me kontent të ngjashëm me atë të institucionit vendor, janë Shqiptarja.com, Syri.net, Albeu e Gazeta Dita.”<sup>53</sup>

Megjithatë, qeveria dhe bashkia nuk mund të kontrollojnë numrin e lartë të mediave online, të cilat janë fuqizuar vitet e fundit me zhvillimin e teknologjisë së informacionit. Për këtë arsye, qeveria është përpjekur për të gjetur rrugë të tjera që të transmetojë materialet e veta apo të censurojë e t'i mbyllë tërësisht keto media. Një nga këto përpjekje është ajo e përdorimit të kaudrit ligjor. Megjithëse shpifja është dekriminalizuar që në vitin 2012, qeveria aktuale inicioi në vitin 2020 një projektligj të

---

<sup>53</sup> Ibid.

quajtur paketa Anti-shpifje. Kjo paketë synonte që të vendoste të gjitha mediat online nën kontrollin e Autoritetit të Mediave audiovizive.

Pra, AMA-s si një rregullator i pavarur dhe i pandikuar nga politika apo ekzekutivi, iu shtua në kompetencë që të merrte përsipër të penalizonte mediat online, të vendoste gjoba, pop-up dhe tërheqje të lajmeve, kur këto të fundit kishin në përmbatje të tyre shpifje kundrejt personave të caktuar, në një kohë që raste të tilla zgjidhen nga gjykata administrative dhe AMA nuk mund të merrte përsipër rolin e gjyqësorit.

Ndërkaq, projektligji për paketën anti-shpifje u kundërshtua nga shoqëria civile, organizatat e medias, rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të mediave të cilat i kanë kërkuar qeverisë shqiptare që respektojë standardet evropiane të lirisë së medias dhe kriteret e Kopengahenit, ndërsa është refuzuar Presidenti i vendit dhe Komisioni i Venecias. Madje, Komisioni i Venecias vërejti se duheshin bërë ndryshime shumta nëse paketa kërkonte të miratohej.<sup>54</sup>

---

<sup>54</sup> DW – “Shqipëri: Paketa ligjore Anti-Shpifje sërish në qendër të debatit”. Linku: <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-paketa-ligjore-anti-shpifje-s%C3%ABrish-n%C3%AB-qend%C3%ABr-t%C3%AB-debatit/a-54985644> [konsultuar më 22.11.2021]

Megjithëse kanë kaluar mbi 12 muaj, Parlamenti nuk ka kryer asnjë ndryshim mbi projektligjin për ta sjellë në standardet e kërkuara, por ai gjendet akoma në rendin e ditës së Kuvendit dhe rrezikon të miratohet ashtu siç u iniciua në fillim. Përveç këtij projektligji, qeveria dhe aktorët e tjerë si Bashkia e Tiranës janë munduar të ndikojnë dhe të censurojnë gazetarët edhe përmes aktorëve të tretë siç është kompania private Akromax, e cila rol të saj ka monitorimin dhe kujdesin për të drejtën e autorit. Por media të ndryshme online, dhe gazetarë të njohur e kanë akuzuar se ajo i shërben kryebashkiakut Veliaj dhe qeverisë së kryeministrit Edi Rama për të censuruar në rrjetet sociale çdo përmbajtje që shkon kundër rrymës së qeverisë dhe bashkisë së Tiranës, duke u fshehur nën petkun e arsyetimit të së drejtës së autorit.<sup>55</sup> Madje edhe Freedom House në raportin për lirinë e medias për vitin 2020, e ka ngritur këtë shqetësim duke e konsideruar si një kërcënim për lirinë e medias dhe gazetarëve “Gazetarët janë gjen-dur nën kërcënime, intimidime dhe sulme nga më të ndryshmet, dhe ata e kanë pasur të pamundur për të reaguar pasi ua kanë mbyllur hapësirat e komunikimit duke sjellë kështu edhe dobësimin e institucioneve

---

<sup>55</sup> “A German company is responsible for the deletion of videos critical of the Albanian government” NetzPolitik.org 19 March 2020. Linku: <https://netzpolitik.org/2020/a-german-company-is-responsible-for-the-deletion-of-videos-critical-of-the-albanian-government/>

*demokratike. Ligji Anti-shpifje dhe kontraktimi i një kompanie private (Acromax Media GmbH) nga qeveria për të hequr përmbajtjen e gazetareve nga rrjetet sociale kanë cenuar rëndë hapësirën dhe lirinë për një raportim të pavarur.”<sup>56</sup>*

Të gjitha mënyrat e lartpërmendura që kanë përdorur nga aktorët politikë për të ndikuar mbi median dhe opinionin publik kanë sjellë pasoja në cilësinë e informacionit si dhe në polarizimin e qytetarëve. Gjithashtu sulmet, fyerjet ndaj gazetareve dhe censurimi i tyre deri mendimet personale të shprehura në rrjetet sociale përbën një situatë të zyrtë për perspektivën e medias shqiptare dhe rritjen profesionale të vetë gazetareve. Duke u ndodhur në këtë situatë shumë gazetarë e kanë braktisur këtë profesion apo janë larguar nga vendi. Problematika që shtrohet në këtë rast është se: **a do të kemi në një të ardhme të afërt qytetarë të mirë-informuar në mënyrë të pavarur mbi situatën dhe zhvillimet e shtetit të së drejtës?**

---

<sup>56</sup> [https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4\\_u30q7pu](https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4_u30q7pu) [konsultuar më 22.11.2021]



### 2.2.3 Reklammat si mjet censurimi

Përgjatë këtij tranzicioni të stërgjzgjatur, media shqiptare është gjendur dhe vijon të përballet me presione nga më të ndryshmet, duke nisur që nga ato politike, të krimit të organizuar apo edhe të interesave të caktuarave ekonomike. Ashtu siç u tha edhe më lart, politika ka tentuar ta dominojnë dhe të ndikojë median përmes shumë mënyrave. Në fillimet e viteve '90 përpjekja për të ndikuar ishte e drejtpërdrejtë, ku aktorët politikë ishin agresivë ndaj medias dhe gazetarëve. Pas këtyre përplasjeve të vazhdueshme, politika filloi të mplekset me pronarët e mediave duke ndërthurur interesave të përbashkëta mes njëri-tjetrit. Duke parë që struktura ekonomike e një media dhe financimi i saj është thelbësore për vijimin dhe jetëgjatësinë, politika dhe bizneset e ndryshme kanë kapur nyjën më nevralgjike të saj, atë ekonomike. Sektori i medias karakterizohet nga një shkallë e lartë përqendrimi të pronësisë dhe shumë gazetarë ndjejnë se tregu nuk iu ofron alternativa më të mira punësimi.<sup>57</sup>

Modeli i biznesit mediatik është i ndërtuar brenda logjikës së ekonomisë shqiptare dhe brenda së

---

<sup>57</sup> Zguri, Rr. (2017). *Artikull i cituar*, f.13. Linku: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf> [konsultuar më 22.11.2021]

cilës funksionojnë edhe bizneset e tjera në vend. Në këtë mënyrë, një nga burimet kryesore të financimit të medias janë edhe reklamat. **Reklamat** vijnë kryesisht nga biznesi privat por edhe nga agjencitë shtetërore. Reklamat që lidhen me kompanitë private përbëjnë pjesën më të madhe të të ardhurave për një media, por këto reklama bartin edhe rrezikun e censurimit të lajmeve që lidhen me këto biznese nëse ato përfshihen nga skandale apo ngjarje të caktuara. Sa i përket reklamave që vijnë nga agjencitë shtetërore censurimi dhe vetëcensurimi është gati një marrëveshje e heshtur kur bëhet fjalë për lajme që mund të jenë kritike me qeverinë. Në këtë rast interesat pronarëve të medias janë të ndërlidhura me qeverinë apo aktorë të tjerë politikë. Në këtë mes janë gazetarët ata të cilët duhet të censurojnë apo të vetëcensurohen kur kuptojnë se një ngjarje lidhet me qeverinë apo emra të caktuar biznesmenësh.

*“Mediat e mëdha fitojnë nga reklamat dhe nga buxheti që i jepet si televizion kombëtar... Por qeveria t'i ndan reklamat. A ndau qeveria përpara shumë vjetësh, që i dha nga 2 milionë euro për procesin e digjitalizimit, që morën 3 televizione? A është një mbyllje goje kjo që të jep qeveria nga 2 milionë euro për procesin e digjitalizimit ndërkohë që duhet ta bësh vetë? ... qeveria cilësohet si kryesore, si shpërndarës i tregut*

të reklamës, se orienton biznesin, orienton keto oligarkët... por edhe mund të pengojë një biznes që të mos reklamojë në një media të caktuar. Për shembull pronari i një mediaje ku punoja unë ankohej se qeveria i pengonte bizneset që të reklamojnë aty.”, thotë një drejtues i një medie audiovizive<sup>58</sup>.

Në tregun shqiptar të reklamave, mënyra e reklamimit në mediat private nuk realizohet nga shikueshmëria apo lexueshmëria, por përmes ‘njohjeve’ të pronarëve dhe biznesmenëve duke e shndërruar reklamimin gati krejt fiktiv dhe duke vendosur në rrezik kredibilitetin e medias përballë opinionit publik.<sup>59</sup> Gjithashtu, përveç abonimeve të transmetimeve dixhitale, në Shqipëri nuk ka një model biznesi të atillë mediatik ku qytetarët të paguajnë për të lexuar produktin gazetaresk. E ndërtuar në kushtet e tregut shqiptar, një pjesë e mirë e mediave nuk i mbulojnë dot shpenzimet e tyre, veçanërisht kur iu duhet kapitali fillestar për të ngritur një media online apo hapur një stacion televiziv. Në këtë

---

<sup>58</sup> KShH, USAID, UK Government dhe Institutit East West Management, *Raport studimor mbi të drejtat e punës së gazetarëve*, f.60–61, 2020, Linku: [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf) [konsultuar më 22.11.2021]

<sup>59</sup> Instituti Shqiptar i Medias - Tregu i reklamave në median shqiptare – fq. 13-14. Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/01/Tregu-i-Reklamave-ne-Median-Shqiptare.pdf> [konsultuar më 22.11.2021]

mënyrë gjenden rrugë të tjera, duke u mbështetur nga financues apo biznesmen, ku pjesa më e madhe e tyre rezulton të lidhur me partinë në pushtet apo aktorë e ndryshëm politikë dhe qeveritarë.

Duke krijuar këtë lidhje me biznesmenë që mund të vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, pronari i medias ndërton një strategji inverse nga ajo e politikës, ku e përdor median e tij për të nxjerrë të ardhura përmes shantazhit apo presionit përmes lajmeve, skandaleve që mund të publikojë ndaj aktorëve politikë. Media në këtë rast shndërrohet në një ‘armë’ që përdoret për t’u mbrojtur dhe sulmuar duke marrë rolin e një “gjybnësi”. Nëse media merr përfitimet e saj nga pasuritë publike si pasojë e favorizimit të aktorëve qeveritarë apo politikë, atëherë lajmi nuk publikohet. Këtë fenomen e konstaton edhe një gazetar me përvojë në median vizive: *“Në shumë raste kam vënë re se gazetarët duhej të bënin lajme që deri diku ishin shantazhuese për drejtues institucionesh, apo drejtues të kompanive të ndryshme private. Kjo kishte si qëllim zhvatjen e fondeve dhe parave prej tyre që do të vinin në formën e reklamave. Unë personalisht kam pasur disa raste të tilla.[...]Shkrimet kundër X vazhduan për disa javë, derisa ato u ndalën në mënyrë të menjëhershme. Më pas në televizion, nisën të shfaqeshin lajme pub-*

*licitare në favor të kompanisë X, por edhe shfaqje spotesh publicitare me pagesë”<sup>60</sup>*

Kjo është një formë vetëcensurimi e dirigjuar që nga pronari i medias për të selektuar ngjarjet që duhet të publikohen apo jo, sipas favoreve monetare që vijnë nga radhët e politikës apo kompanive private. Në këtë rast, gazetaria shndërrohet në një biznes gjobvënie ku humbet interesi për informimin e opinionit publik dhe synimi primar bëhen përfitimet monetare. Tregu i reklamave dominohet kryesisht nga kompanitë e telefonisë celulare, si dhe sistemi bankar në vend. Shpeshherë këto kompani përcaktojnë edhe politikën editoriale të mediave, dhe rrisin censurën e vetëcensurën te gazetarët. Një shembull i tillë është ai vitit 2017 kur Autoriteti i Konkurrencës nisi një hetim rreth mbi problematikën e konkurrencës së kompanive celulare lidhur me paketat e rimbushjes që ofronin në treg. Lajmin e publikuan vetëm disa media ndërsa pjesa tjetër heshti sepse kishin përfitime direkte nga kompanitë celulare që vinin përmes reklamave.

*“Burimet e financimit të mediave nuk janë të diversifikuara sa duhet dhe kompanitë e mëdha sponsorizuese, si kompanitë e celularëve, vazhdojnë të*

---

<sup>60</sup> Ibid, f. 62

*kenë rëndësi shumë të madhe për mbijetesën e mediave. Për pasojë, ato janë në gjendje të influencojnë politikën editoriale të mediave, dhe kjo është arsyeja pse nuk shohim kritika rreth këtyre kompanive në media. Edhe nëse ka ndonjë kritikë mbi këto kompani, kjo ndodh se media po mundohet të tërheqë financime prej tyre.”<sup>61</sup>*

Nga ana tjetër, ka pasur raste kur vetë politika ka përdorur kompanitë private për të bërë presion ndaj medias. Përgjatë pandemisë së krijuar nga Covid-19 në vitin mars të vitit 2020, kryeministri Edi Rama përdori kompaninë celulare ‘Vodafone’ duke iu sugjeruar shqiptarëve që të mos informohen përmes medieve. Kryeministri jepte këshilla përmes një mesazhi audio se si qytetarët të mbroheshin nga koronavirusi, ku këta të fundit ishin të detyruar të dëgjonin këtë mesazh para telefonatave thirrëse apo marrëse të tyre. Megjithëse mesazhi transmetohej në mënyrë të rastësishme një herë në disa telefonata, ky mesazh shoqërohej edhe me një sulm ndaj medieve në të cilin kreu i qeverisë iu kërkonte qytetarëve që të ruheshin jo vetëm nga koronavirusi edhe por edhe nga media. “..është një shkelje

---

<sup>61</sup> ISHM, *Media shqiptare dhe standardet evropiane*, (Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës mbi Median në Demokraci), f.40, 2018. Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/Media-shqiptare-dhe-standardet-evropiane.pdf>

flagrante e etikës, standardeve profesionale dhe ndoshta edhe ligjit të privatësisë nga ana e kompanisë Vodafone, e cila është bërë bashkëpunëtoresh me Ramën në sulmin ndaj lirisë së mediave.”<sup>62</sup>

Për të kuptuar se si reklama dhe lidhjet e politikës me pronarët e medias ndikon në censurimin të gazetarëve dhe lajmit që ata raportojnë, duhet të shohim më parë strukturën e tregut të medias shqiptare. Tregu i medias shqiptare kontrollohet nga një grup i vogël pronarësh të cilët kanë lidhje të forta me politikën. Sipas një studimi të realizuar Rrjeti Ballkanik për Gazetari Investigative në Shqipëri (BIRN Albania) dhe Reporterë Pa Kufij (RSF) konstatohet një përqendrim i lartë i tregut të medias shqiptare në pak duar e cila përcakton edhe pavarësinë e këtyre medieve që zotërojnë. “...katër pronarët kryesorë në segmentin e televizioneve, Familja Frangaj, Familja Hoxha, Familja Dulaku dhe Familja Ndroqi, arrijnë gjysmën e audiencës totale (mes 48.93% dhe 58,60%. Tre pronarë kanë pesë licenca transmetimi dixhital, nga të cilat njëri ka marrë tre. Në radio, përqendrimi i audiencës është edhe më i lartë, ku katër pronarë kontrollojnë pothuajse dy të tretat

---

<sup>62</sup> Reporter.al - Rama përshkallëzon “luftën” e tij kundër medias në telefonat celularë - <https://www.reporter.al/rama-pershkallezon-luften-e-tij-kunder-medias-ne-telefonat-celulare/>

(63.69%) e audiencës. Një nivel mesatar përqendrimi mund të dallohet vetëm te shtypi, ku katër pronarët kryesorë kanë një lexueshmëri të kombinuar prej 43.29%. Ndërsa matjet edhe të pronësisë ndërsektoriale të medias, TV, shtyp, radio dhe online, “zbuluan se të tetë pronarët kryesorë arrijnë një audiencë që varion nga 72,1% deri në 80.1%”.<sup>63</sup>

Të dhënat e mësipërme tregojnë se si tregu i vogël i medias shqiptare është i mbingopur duke krijuar presione të ashpra ekonomike si dhe duke përqendruar në pak duar jo vetëm pronësinë mbi median por edhe shpërndarjen e reklamave. Në këtë mënyrë pjesën më të madhe të të ardhurave që gjenerohen në këtë treg e përfitojnë ato pak grupe mediatike që janë nën pronësi familjare, siç i kemi evidentuar edhe më lart. “Përqendrimi brenda tregut të transmetimeve televizive pa pagesë të katër pronarët më të mëdhenj është 89.6% – ku dy më të mëdhenjtë më vete kontrollojnë më shumë se dy të tretat e tregut (71.7% të të ardhurave) – dhe rritet në 94% në rast se përfshihen edhe rrjetet e transmetimit dixhital si dhe transmetuesi publik”.<sup>64</sup>

---

<sup>63</sup> Zëri i Amerikës. *Shqipëri, pronarët e mediave me lidhje të forta politike*. Linku: <https://www.zeriamerikes.com/a/4296220.html>

<sup>64</sup> Ibid.



Po sipas këtij studimi, audienca e pronarëve me lidhje politike varion nga 65,18% në 75,86%. Në këtë rast edhe autoriteti rregullues, siç është Autoriteti i Medias Audiovizive nuk ka ndërhyrë për të vendosur balancat, ndërsa edhe vetë ky institucion ndodhet nën ndikimin e aktorëve politikë, kryesisht atyre në qeverisje. Ky rreth vicioz i lidhjeve të politikës dhe pronarëve të medias të cilët kanë edhe biznese të tjera nën administrim prodhojnë një linjë editoriale të përcaktuar qartë duke rritur presionin mbi gazetarët për t'u vetëcensuruar apo për të censuruar lajme të cilat lidhen me bizneset e tjera të medias ku punojnë. *“Përveç rrjetit të komplikuar që krijohet rreth interesave të lidhura të pronarëve të medias, klima e medias në Shqipëri është nën presion edhe nga një seri faktorësh të tjerë, përfshirë reklamuesit e mëdhenj korporativ dhe institucionet qeveritare. Gjithsesi, asnjë nga këto faktorë të jashtëm nuk luan një ndikim aq të madh për t'i shtyrë gazetarët drejt vetëcensurës se sa interesat ekonomike dhe politike të pronarëve.”*<sup>65</sup>

Duke pasur një pushtet të tillë, pronarët e medieve kryesore në vend deformojnë edhe linjën profesionale të edicioneve të lajmeve në stacionet televizive. Kjo ndodh për shkakun se në televizionet

---

<sup>65</sup> Ibid.

më të mëdha, veçanërisht ato kombëtare transmetohen kronika të cilat kanë përmbajtje tregtare të cilat nuk kanë përmbajtje të lajmit por kanë tërësisht elemente të marketingut. Në shumicën e rasteve kjo nuk shënohet në ekran si reklamë dhe për më tepër transmetohen brenda edicionit informativ, i cili presupozohet që të jetë i pavarur dhe i paanshëm në transmetimin e kronikave të tilla. Në kronikat-reklamë favorizohen dhe reklamohen produktet e bizneseve, që janë nën administrimin e pronarëve të këtyre medieve si dhe reklamimin e bizneseve të tjera të lidhura tërthorazi me pronarët e medieve. Megjithëse ligji për mediat Audiovizive dhe Kodi i Transmetimit e ndalon transmetimin e kronikave me përmbajtje tregtare përgjatë edicionit të lajmeve kjo nuk i ka penguar televizionet kombëtare si apo lokale për të transmetuar materiale të tilla. Duke përdorur gazetarët për të raportuar kronika të tilla me përmbajtje të reklamës, gazetarët dalin jashtë rolit të tyre për të raportuar me paanësi dhe objektivitet. Sipas një monitorimi 3 mujor që Qendra 'MediaLook' ka bërë ndaj 276 edicioneve informative të orës 19:00 dhe 19:30 të tre televizioneve kombëtare "...ka rezultuar një total prej 51 kronikash, nga të cilat 20 në TV Klan, 18 në Vizion Plus dhe 13 lajme në televizionin Top Channel. Ndërkaq, koha totale kushtuar këtyre lajmeve për periudhën e monitoruar është 35.59 minuta në Vizion Plus e ndjekur nga

*35.19 minuta në TV Klan dhe një kohë transmetimi afro 13 minuta në Top Channel. Të dhënat për këtë të fundit duhen marrë me rezervë për shkak se edicionet informative të këtij kanali janë hedhur të pa plota në faqen zyrtare në YouTube dhe kronikat mbi lajmet e kinemasë janë përlogaritur apriori 45 sekonda.”<sup>66</sup>*

Nga ana e saj Autoriteti i Medias Audiovizive, megjithëse ka monitoruar edicionet informative të këtyre televizioneve nuk ka konstatuar në raportin e tij asnjë kronikë me përmbajtje të reklamës. Duke vëzhguar 2100 edicione në subjektet audiovizivë kombëtarë në raportin e tij nuk gjenden kronika-reklamë për të evidentuar si shkelje ndaj ligjit për median audiovizive.<sup>67</sup> E njëjta situatë konstatohet edhe për raportin vjetor për vitin 2020. Sipas raportit të AMA-s, *“në subjektet audio dhe audiovizive kombëtare janë monitoruar rreth 2,600 edicione informative 1,500 edicione të subjekteve audiovizive kombëtare dhe 1100 edicione të subjekteve audio kombëtare. Raporti evidenton më tej se për monitorimin e reklamave në subjektet audiovizive kombëtare janë rreth 25,500*

---

<sup>66</sup> Qendra MediaLook, AMA “e pafuqishme” ndaj TV-ve, lejon kronikat “reklamë” në edicionet informative. Linku: <https://www.medialook.al/ama-e-pafuqishme-ndaj-tv-ve-lejon-kronikat-reklame-ne-edicionet-informative/>

<sup>67</sup> AMA, Raporti Vjetor 2017, linku: <https://www.medialook.al/wp-content/uploads/2019/02/Raporti-vjetor-AMA-2017.pdf>

orë programe të monitoruara.”<sup>68</sup> AMA shpjegon se vlerësohet vetëm një edicion informativ në ditë, i televizioneve kombëtare, si bartës i linjës editoriale, duke bërë në këtë mënyrë që transmetuesit televizivë t’i transmetojnë kronikat-reklamë në një edicion tjetër gjatë ditës, që nuk monitorohet nga Autoriteti i Mediave Audiovizive. Panorama e përshkruar më lart e tregut mediatik shqiptar ku ndërthuren interesat e politikës, pronarëve dhe biznesmenëve të medias, të cilët zotërojnë edhe biznese të tjera përtej politikës, duke ndikuar direkt në punën dhe cilësinë e raportimit profesional të gazetarëve, përbën një shqetësim real për zhvillimin e konkurrencës së medias në Shqipëri. Duke u dominuar nga pak duar, tregu mediatik shqiptar rrezikon të deformohet duke prodhuar një situatë informale e cila në shumicën e rasteve siç u evidentua edhe më lart nuk korrigjohet as nga organizma mbikqyrës siç është edhe Autoriteti i Mediave Audiovizive, pasi edhe ky institucion është nën ndikimin politik. Nga ana tjetër, megjithëse në aspektin teknologjik media shqiptare është në parametra dhe standarde të vendeve të zhvilluara, standardi profesional mbetet i ulët, pasi faktorët e përmendur më lart e kanë dëmtuar statusin dhe rolin e gazetarit.

---

<sup>68</sup> AMA, Raporti Vjetor 2020, linku: [http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-Vjetor-i-AMA\\_2020.pdf](http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-Vjetor-i-AMA_2020.pdf)



# LIRIA E MEDIAS SI E DREJTË THEMELORE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

Liria e shprehjes dhe ajo e medias si të drejta themelore kanë gjetur një garanci dhe rregullim në nivel ndërkombëtar pas Luftës së Dytë Botërore. Në vijim do të trajtojmë garancitë e lirisë së medias në nivelin ndërkombëtar të përgjithshëm (traktatet dhe rezolutat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara [OKB]), si dhe ndërkombëtar rajonal (Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë), duke i konkretizuar këto të fundit me shembuj nga jurisprudenca evropiane.

## **3.1 Këndvështrimi botëror – Organizata e Kombeve të Bashkuara**

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, e ka konsideruar të drejtën për informim si themel për kërkimin e

të gjithë të drejtave të tjera. Kjo e drejtë përfshin për të mbledhur, transmetuar dhe publikuar lajme kudo pa u penguar nga asnjë rrethanë<sup>1</sup>. Kështu, ajo është konsideruar të jetë e drejta e medias për të kryer detyrën e saj themelore – informimin e qytetarëve pa pengesa<sup>2</sup>.

Media, megjithëse pa gëzuar një të drejtë ekskluzive për informacion, qoftë në lidhje me aksesin apo me shpërndarjen, është një aktor kryesor në lidhje me këtë të drejtë. Kështu, liria e medias, e cila është një e drejtë e të gjithë qytetarëve, është një ndërlidhje mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për informim<sup>3</sup>.

OKB-ja përmes deklaratave, konventave, pakteve dhe rezolutave të miratuara ka garantuar ndër vite lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim, përfshirë këtu dhe lirinë e medias. Kështu, prej **Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut** (DUD-NJ), që është vlerësuar si reagimi i parë juridik mes dy luftërave botërore, garantohet liria e shprehjes dhe e drejta për informim. Të njëjtën linjë duke ga-

---

<sup>1</sup> <https://www.refworld.org/docid/3b00f0975f.html> [konsultuar më 20.11.2021].

<sup>2</sup> Darbshire, H. (1997, May). Data Protection and Freedom of Information, “Access to information and the media”, Budapest, Hungarian Civil Liberties Union, p. 68.

<sup>3</sup> Ibid.

rantuar këto të drejta ka mbajtur dhe **Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike** në nenin 19 të tij<sup>4</sup>.

Rezolutat e OKB-së kanë për qëllim të rrisin nivelin e mbrojtjes së gazetarëve në vendet anëtare<sup>5</sup>, rreth 12 prej këtyre rezolutave i referohen vetëm sigurisë së gazetarëve. Gjithashtu, qëllimi i miratimit të tyre lidhet dhe me dënimin e gjendjes aktuale të mos-ndëshkimit për veprimet e dhunës ndaj gazetarëve dhe ato të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e profesionit të tyre. Në vijim do të ndalemi të shpjegojmë disa nga dokumentet më të rëndësishme për qëllime të këtij materiali.

Këshilli i të Drejtave të Njeriut ka miratuar **Rezolutën nr. 21/12 (viti 2012) mbi sigurinë e gazetarëve**<sup>6</sup>, qëllimi i së cilës është shprehja e shqetësimit për sulmet ndaj gazetarëve të cilat kalojnë pa u ndëshkuar nga askush. Përmes kësaj rezolute Këshilli u bëri thirrje shteteve anëtare të shfaqin përgjegjësi duke kryer hetime të paanshme, të shpejta dhe efektive, duke evidentuar personat që kanë kryer këto sulme.

---

<sup>4</sup> Petrela, I. & Kodra, K. (2017). *Cituar më lart*, 4-6.

<sup>5</sup> <https://www.ohchr.org/EN/Issues/SafetyOfJournalists/Pages/resolutions.aspx> [konsultuar më 21.11.2021].

<sup>6</sup> <https://undocs.org/A/HRC/RES/21/12> [konsultuar më 21.11.2021].

**Rezoluta nr. 68/163 (viti 2013) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit**<sup>7</sup>, u bëri edhe një herë thirrje shteteve anëtare për të marrë masa efektive në parandalimin e dhunës ndaj gazetarëve. Rezoluta thekson domosdoshmërinë e krijimit të një mjedisi të sigurt për gazetarët me qëllim sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë të punës së tyre. Masat e nevojshme pozitive, që duhet të ndërmarrin shtetet, sipas kësaj rezolute përfshijnë: a) kuadrin ligjor; b) ndërgjegjësimin e përfaqësuesve të pushtetit gjyqësor mbi garancitë ndërkombëtare të lirisë së medias; c) monitorimin, raportimin dhe dënimin e sulmeve ndaj gazetarëve; d) aksesin në mjete efektive për dënimin e sulmeve ndaj medias dhe profesionistëve të saj.

**Rezoluta 27/5 (viti 2014), e Këshillit për të Drejtat e Njeriut, për sigurinë e gazetarëve**, u bëri thirrje shteteve anëtare për të krijuar strategji kundër mosndëshkimit të sulmeve ndaj gazetarëve. Gjithashtu, kjo rezolutë sugjeroi: a) krijimin e njësive të posaçme hetimore ose komisione të pavarura; (b) emërimin e prokurorëve të specializuar për ndjekjen e këtyre veprave penale; (c) miratimin e protokolleve dhe metodave specifike të hetimit dhe ndjekjes pe-

---

<sup>7</sup> <https://undocs.org/en/A/RES/68/163> [konsultuar më 21.11.2021].



nale; (d) trajnimin e prokurorëve dhe gjyqësorit për sigurinë e gazetarëve; (e) krijimin e mekanizmave të mbledhjes së informatave, siç janë bazat e të dhënave, për të mundësuar mbledhjen e informacionit të verifikuar për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve; (f) krijimin e një mekanizmi për paralajmërim të hershëm dhe reagimin e shpejtë për t'u mundësuar gazetarëve, akses të menjëhershëm tek autoritetet dhe masat mbrojtëse”.

**Rezoluta 69/185 (viti 2014) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara<sup>8</sup> mbi sigurinë e gazetarëve dhe çështjen e mosndëshkimit,** përveç theksimit edhe një herë të rëndësisë për të ndëshkuar autorët e sulmeve ndaj gazetarëve, si dhe kryerjen e hetimeve të pavaruara dhe efektive ndaj këtyre veprave, theksoi rëndësinë për të ndaluar torturën, vrasjen, zhdukjen me forcë dhe arrestimet arbitrare ndaj gazetarëve.

Në po të njëjtën linjë është dhe **Rezoluta e miratuar nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut<sup>9</sup>, më datë 27 shtator 2018,** me anë të së cilës shtetet u inkurajuan edhe

---

<sup>8</sup> <https://undocs.org/en/A/RES/69/185> [konsultuar më 21.11.2021].

<sup>9</sup> <https://undocs.org/en/A/HRC/RES/45/18> [konsultuar më 21.11.2021].

një herë për të kryer hetime ndaj sulmeve, kërcënimeve dhe akuzave për dhunë ndaj gazetarëve.

Pas një vështrimi të përgjithshëm të disa prej rezolutave të miratuara nga OKB-ja përmes strukturave të saj, vërejmë se në rrafsh ndërkombëtar ekziston një **nevojë emergjente për të mbrojtur gazetarët nga sulmet kundër tyre**, duke u mundësuar atyre jo vetëm akses në mjete efektive kundër këtyre sulmeve, por dhe sigurimi i mjeteve të nevojshme për hetimin e këtyre veprave.

## 3.2 Këndvështrimi evropian

### 3.2.1 Legjislacioni dhe mekanizmat mbrojtës të Këshillit të Evropës

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** është akti kryesor i miratuar nga Këshilli i Evropës më 4 nëntor 1950, karakteri i të cilit është ndërkombëtar rajonal<sup>10</sup>. Konventa shtrin juridiksionin e saj vetëm në 47 shtetet anëtare të KiE.

Konventa garanton lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim në:

---

<sup>10</sup> [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf) [konsultuar më 21.11.2021].

## Neni 10

- 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërrhyjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me liçencë.*
- 2. Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.*

Neni 10 mbron një prej lirive themelore të qytetarëve pa të cilën bëhet e pamundur kërkesa për të respektuar liritë e të drejtat e tjera. Kështu, përmes tij mbrohet e drejta për të pasur mendime, si dhe për të marrë e shkëmbyer informacione. Pra, garantohet liria e shprehjes e njëherazi e drejta për informim. Ndërkohë, kjo e drejtë e cila bën pjesë tek të drejtat materiale të garantuara nga Konventa, mund të kufizohet sipas kritereve të sanksionuara në paragrafin 2 të nenit 10<sup>11</sup>. Kufizimet e vendosura në këtë nen pasqyrojnë situatën e zhvillimit të kohës kur është hartuar KEDNJ dhe jo idealet e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut<sup>12</sup>.

Ky nen nuk e përmend shprehimisht lirinë e shtypit, por jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut e ka garantuar një mbrojtje të tillë, pasi e drejta për informim sjell të drejtën e gazetarëve për të marrë e shkëmbyer informacion, me qëllim informimin e publikut<sup>13</sup>. Liria e shtypit gëzon mbrojtje më të gjerë veçanërisht në rastet ku informacioni përbën çështje të interesit publik. Ndaj në

---

<sup>11</sup> Mole, N. & Kamber, k. & Liaki, V. (2018). *Drejt një Zbatimi Efektiv në Nivel Kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Londër: AIRE Centre, f. 18-25.

<sup>12</sup> Darbshire, H. (1997, May). *Cituar më lart*, p. 69.

<sup>13</sup> Siniarska-Bychawska, D. (2018). *Mbrojtja e të drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: manual për praktikantët e ligjit*, Tiranë: Onufri, f. 87-88.

publikimet ose artikujt, që kanë të bëjnë me çështje politike shtetet e kanë shumë të vështirë të justifikojnë ndërhyrjen<sup>14</sup>. Ky qëndrim është mbajtur nga Gjykata në çështjen *Observer dhe Guardian Newspapers k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>15</sup>.

Një nga pikat më të nxehta të të drejtave të rrjedhura nga garantitë e nenit 10 të Konventës është dhe mbrojtja e burimeve të gazetarëve. Gazetarët argumentojnë se nëse nuk janë në gjendje ti mbrojnë burimet e tyre të informacionit, atëherë informacionet me interes për publikun, të cilat shpesh prekin dhe interesin e qeverisë, nuk do të mund të publikohen. **Mbrojtja e burimeve gazetareske** garantohet në ligjin e disa shteteve evropiane, ndërkohë disa të tjerë i mbrojnë përmes praktikës këto burime<sup>16</sup>. Kjo çështje është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Strasburgut në rastin *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*<sup>17</sup>, ku gjykatat vendase i kërkonin gazetarit të tregonte burimin e informacionit për të dhënat, që kish publikuar për një kompani. GJEDNJ

---

<sup>14</sup> Bianku, L. (2020). *Drejt praktikës: pwrdorimi i jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut në nivel vendas*. Tiranë: Qendra Europiane, f. 277.

<sup>15</sup> *Observer dhe Guardian Newspapers k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13585/88, datë 26 nëntor 1991.

<sup>16</sup> Darbshire, H. (1997, May). *Cituar më lart*, p. 75.

<sup>17</sup> *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 28957/95, datë 11 korrik 2002.

u shpreh se mbrojtja e burimeve të informacionit të gazetarëve përbën kusht thelbësor për respektimin e lirisë së medias. Mungesa e një mbrojtjeje të tillë do të cenonte mundësinë e medias për të dhënë informacione të besueshme<sup>18</sup>.

Përveç detyrimit negativ për të njohur lirinë e medias, shteteve anëtare u lindin dhe një sërë detyrimesh pozitive, me qëllim zbatimin efektiv të kësaj lirie dhe mbrojtjen e gazetarëve. Kështu, shtetet ndër të tjera kanë detyrim:

- Në lidhje me nenin 2<sup>19</sup> - për të ndërmarrë një hetim efektiv në rastet kur është cenuar jeta e gazetarëve, nëse kjo ngjarje ka ndodhur për shkak të profesionit<sup>20</sup>.
- Në lidhje me nenin 3<sup>21</sup> - të mos përdorin dhunë ndaj gazetarëve;

---

<sup>18</sup> Bianku, L. (2020). *Cituar më lart*, f. 287.

<sup>19</sup> Neni 2 – E drejta e jetës - 1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. [...].

<sup>20</sup> *Dink k. Turqisë*, nr. 2668/07, 6102/08, 30079/08, datë 14 shtator 2010.

<sup>21</sup> Neni 3 – Ndalimi i torturës - Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.

- Në lidhje me nenin 5<sup>22</sup> dhe 6<sup>23</sup> – të mos ndalojnë pashkak gazetarët; si dhe ti mundësojnë atyre në rast mosmarrëveshjes gjyqësore, një hetim efektiv, të pavarur dhe të paanshëm.

Sipas parashikimit të nenit 10, shtetet gëzojnë një hapësirë vlerësimi për sa i përket rregullimeve ligjore specifike për licencimin e operatorëve të medias. Mungesa e kuadrit ligjor për licencim mund të përbëjë në vetvete shkelje të nenit 10 të Konventës. Megjithatë, këto kompetenca duhet të ushtrohen vetëm për qëllime teknike, duke mos ndikuar tek pluraliteti i informacionit dhe të mos ndërhyjnë në thelbin e të drejtës për informim dhe lirisë së medias<sup>24</sup>.

---

<sup>22</sup> Neni 5 – E drejta për liri dhe siguri - 1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: [...].

<sup>23</sup> Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt - 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. [...].

<sup>24</sup> Siniarska-Bychawska, D. (2018). *Cituar më lart*, f. 93-94.

Mbrojtja e lirisë së medias është zgjeruar më tej nga Këshilli i Evropës përmes disa rekomandimeve të cilat forcojnë mbrojtjen e garantuar nga Konventa dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Në vazhdim do të listojmë rekomandimet më të rëndësishme lidhur me temën qendrore të këtij manuali.

- **Rekomandimin e Komitetit të Ministrave mbi të drejtën e gazetarëve për të mbrojtur burimet e informacionit (2000)**<sup>25</sup>, përcakton sugjerime të detajuara rreth detyrimeve të autoriteteve dhe të drejtës së gazetarit për të heshtur me qëllim mbrojtjen e burimeve gazetareske.
- **Rekomandimi për barazinë gjinore dhe median (2013)**<sup>26</sup>, tërheq vëmendjen e të gjithë shteteve anëtare për të luftuar stereotipet seksiste dhe dhunën me bazë gjinore në media.

---

<sup>25</sup> [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-no-r-2000-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-right-of-journalists-not-to-disclose-their-sources-of-information?inheritRedirect=false](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-no-r-2000-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-right-of-journalists-not-to-disclose-their-sources-of-information?inheritRedirect=false) [konsultuar më 26.11.2021]

<sup>26</sup> [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2013-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-gender-equality-and-media-adopted-by-the-committee-of-ministers-on-10-j?\\_101\\_INSTANCE\\_aDXmrol0vvsU\\_viewMode=view/](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0vvsU/content/recommendation-cm-rec-2013-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-gender-equality-and-media-adopted-by-the-committee-of-ministers-on-10-j?_101_INSTANCE_aDXmrol0vvsU_viewMode=view/) [konsultuar më 26.11.2021]



- **Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2016)**<sup>27</sup> mbron çdo person ose ent që kontribuon në debat publik, duke përfshirë gazetarët, sinjalizuesit, akademikët, OSHC-ët etj, si dhe kërkon që shtetet të krijojnë një *mjedis të favorshëm* për ushtrimin e së drejtës për lirinë e shprehjes dhe të ofrojnë kushte në të cilat mund të lulëzojë debati i fuqishëm publik. Për zbatimin e plotë të Rekomandimit në pjesën e mbrojtjes së gazetarëve dhe ndjekjes penale të autorëve të veprave penale kundër gazetarëve, Këshilli i Evropës ka miratuar edhe një Udhëzues për zbatimin e temave të zgjedhura për mbrojtjen e gazetarisë dhe sigurinë e gazetarëve dhe aktorëve të tjerë të mediave.
- **Rekomandimi për pluralizmin mediatik dhe transparencën e pronësisë së medias (2018)**<sup>28</sup> trajton çështjet e pluralizmit dhe diversitetit mediatik në mjedisin e ri të multimedias.

---

<sup>27</sup> [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#\\_ftn1](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1) [konsultuar më 26.11.2021]

<sup>28</sup> <https://rm.coe.int/leaflet-media-freedom-en/16808b53e4> [konsultuar më 26.11.2021]

- **Rezoluta nr. 2317 (2020)** miratuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës u bëri thirrje shteteve anëtare të mbrojnë në mënyrë më efektive sigurinë e gazetarëve dhe lirinë e mediave.

### 3.2.2 Kuadri rregullues i Bashkimit Evropian në lidhje me median

Pavarësisht se Shqipëria nuk është vend anëtar i Bashkimit Evropian, aspirata jonë për tu anëtarësuar në BE, sjell detyrimin për përafrimin e legjislacionit tonë me *aquis*. Për rrjedhojë, ne do të paraqesim në këtë manual një panoramë të shkurtër të rregullimeve ligjore në lidhje me lirinë e medias në nivel unioni. Duhet theksuar se parimet e mbrojtjes së këtyre lirive e të drejtave janë të njëjta me ato të elaboruara nga KiE.

Në BE liria e medias është trajtuar për një kohë të gjatë vetëm për qëllime të lidhura ekskluzivisht me tregun e përbashkët evropian. Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (GJDBE) ka theksuar rëndësinë e kësaj lirie me qëllim garantimin e demokracisë dhe pluralizmit në union<sup>29</sup>. Reflek-

---

<sup>29</sup> <https://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-554214-Press-freedom-in-the-EU-FINAL.pdf> [konsultuar më 23.11.2021].

timet e Gjykatës u pasqyruan më pas në reformën institucionale e ligjore të ndodhur me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës në 2009. Liria e shprehjes dhe e drejta për informim konsiderohen tashmë si të drejta themelore në BE dhe garantohen nga neni 11 i Kartës së BE për Liritë dhe të Drejtat Themelore (Karta). Karta është pjesë e legjislacionit evropian<sup>30</sup> prej dhjetorit 2009.

## Neni 11

- 1. Çdokush gëzon lirinë e shprehjes. Kjo e drejtë duhet të përfshijë të drejtën për të pasur një mendim dhe për të marrë dhe dhënë informacion dhe ide pa asnjë ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pa kufizim.*
- 2. Liria dhe pluraliteti i medias duhet të respektohen.*

Nëse krahasojmë nenin 11 të Kartës së të Drejtave Themelore me nenin 10 të KEDNJ, Karta si një katalog më modern, që mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut ka parashikuar në tekstin e saj dhe garanci të drejtpërdrejta për median.

---

<sup>30</sup> Traktati i Lisbonës, neni 6 (1).

Një akt tjetër ligjor në kuadër të së drejtës së BE-së është Direktiva për Shërbimet Mediatike Audiovizuale<sup>31</sup>, e cila harmonizon rregullimet ligjore kombëtare mbi median audiovizive, duke i kushtuar rëndësi të veçantë reklamave për qëllime tregtare. Gjithashtu, kjo direktivë parashikon detyrimin e shteteve anëtare për të ndaluar gjuhën e urrejtjes dhe gjuhën fyese ndaj të miturve në media. Direktiva i kushton një rëndësi të veçantë dhe përqendrimin të pronësisë së medias. Ajo kërkon nga shtetet palë të parandalojnë veprimet, që mund të cenojnë pluralizmin e medias, si dhe të mundësojnë organet e pavarura rregullatore të bëjnë punën e tyre<sup>32</sup>. Në këtë rast pluraliteti i medias referohet në aspektin e jashtëm dhe të brendshëm p.sh. numri i ofruesve të shërbimeve mediatike në një shtet<sup>33</sup>.

Megjithatë, mekanizmat vetërregullues të medias vuajnë shpesh nga mungesa e efektivitetit, pasi kodet e sjelljes qëndrojnë poshtë standardeve ligjore, si edhe për faktin se këto organe nuk kanë në dispozicion mekanizma sanksioni efektiv<sup>34</sup>. Në nivel Unioni është krijuar një mekanizëm rregullator, i

---

<sup>31</sup> Direktiva 2021/13/EU, datë 10.03.2010.

<sup>32</sup> Paragrafet 8 dhe 94 të Direktivës.

<sup>33</sup> <https://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-554214-Press-freedom-in-the-EU-FINAL.pdf> p. 5.

<sup>34</sup> Ibid, p. 6.

cili këshillon Komisionin Evropian në zbatimin e Direktivës për Shërbimet Mediatike Audiovizuale, lehtëson bashkëpunimin mes organeve rregullatore në BE, si dhe kujdeset për shkëmbimin e eksperiencave. Ky institucion është Grupi i Rregullatorëve Evropian për Shërbimet Mediatike Audiovizuale<sup>35</sup>.

Rekomandimi<sup>36</sup> i Komisionit Evropian për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve në vendet e BE do të ndihmojë në fuqizimin e lirisë së medias dhe pluralizmit të saj. Ky rekomandim synon të garantojë kushte pune më të sigurta për të gjithë profesionistët e medias.

GJDBE ka elaboruar dhe vazhdon të elaborojë një jurisprudencë të gjerë sa i takon mbrojtjes së lirisë së medias në vendet e Unionit, veçanërisht përballë situatave problematike në disa prej këtyre vendeve ku liria e medias është gjendur në rrezik. Garancia e medias së lirë është garanci për funksionimin e parimeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në BE.

---

<sup>35</sup> [https://erga-online.eu/?page\\_id=7](https://erga-online.eu/?page_id=7) [konsultuar më. 25.11.2021]

<sup>36</sup> Commission Recommendation 16.9.2021 on ensuring the protection, safety and empowerment of journalists and other media professionals in the European Union

### 3.2.3 Standardet e OSBE

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) si pjesë e misionit të saj monitoron zhvillimet e medias në shtetet e saj pjesëmarrëse me qëllim evidentimin e rasteve të shkeljes të lirisë së shprehjes. Kjo detyrë përfshin: monitorimin dhe kërkimin e përgjegjësisë për vrasjet, sulmet dhe ngacmimet e gazetarëve dhe ndjekjen penale të gazetarëve dhe anëtarëve të medias për aktivitetet e tyre profesionale; rishikimin e legjislacionit që mund të ndikojë në shprehjen e lirë dhe legjislacionit që rregullon median. Gjithashtu, OSBE angazhohet në zhvillimin e medias përmes trajnimit dhe mbështetjes për redaktorët dhe gazetarët. Disa dokumenta të miratuara nga kjo organizatë në fushën e lirisë së shprehjes dhe medias janë:

- **Dokumenti i Takimit të Moskës të Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të OSBE-së (1991)**, i cili citon se mediat e pavarura janë thelbësore për një shoqëri të lirë dhe të hapur dhe sistemet e përgjegjshme të qeverisjes janë të një rëndësie të veçantë në mbrojtjen të drejtave të njeriut dhe liritë themelore.
- **Vendimi për sigurinë e gazetarëve nga të 57 shtetet pjesëmarrëse në Këshillin**

**Ministror të OSBE-së (2018)**<sup>37</sup> ku theksohet se shtetet duhet të respektojnë zotimet e OSBE-së për të garantuar lirinë e shprehjes dhe të medias përmes kuadrit ligjor dhe politik, si dhe të marrin masa për rastet kur këto liri cenohen.

Edhe përmes Prezencës në Shqipëri OSBE-ja ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol aktiv në promovimin e standardeve për një media të lirë e të pavarur.

---

<sup>37</sup> <https://www.osce.org/files/mcdec0003%20safety%20of%20journalists%20en.pdf> [konsultuar më 27.11.2021].

# IV

## ROLI I MEDIAS NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

Pas rënies së regjimit shtypës komunist për Shqipërinë lindi nevoja e ristrukturimit ekonomik, politik dhe shoqëror. Një nga proceset e këtij ristrukturimi lidhet edhe me nevojën e informimit, i cili para viteve '90 kryhej sipas direktivave të regjimit totalitar. Duke mos pasur një traditë të zhvillimit mediatik dhe lëvrimit të informacionit, në fillim të viteve '90 mediat e para ishin derivat i partive politike dhe jo iniciativë i individëve të tjerë; profesionistë të medias apo biznesmenë, të cilët do vinin shumë më vonë në skenën mediatike.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> "Shtypi komunist si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin totalitar shqiptar 1960-1970", Sokol Paja, fq. 1, 2015. Linku: <https://aab-edu.net/wp-content/uploads/2020/02/02-2015-SQ-20-Sokol-Paja-1.pdf>



Në këtë mënyrë, ato që e paraprijnë procesin e zhvillimit mediatik, janë partitë politike dhe jo rasisht organi i parë mediatik i viteve të para të pluralizmit ishte Rilindja Demokratike (5 janar 1991) organ i Partisë Demokratike, partisë së parë opozitare në vend.<sup>2</sup> Ajo do të pasohej nga gazeta të tjera që ishin gjithashtu organe të partive të ndryshme politike, që gjithsesi krijojnë një larmishmëri në aspektin e informimit edhe pse informacioni ishte në kufijtë e propagandës dhe mesazhit politik. Media shqiptare po zhvillohej dhe formohej në konturet e ristrukturimit të një shoqërie që sapo kishte dalë nga regjimi komunist, e cila po tentonte t'i përshtatej një fryme të re, e drejtuar nga ekonomia e tregut, por edhe me perspektivë drejt Bashkimit Evropian, edhe pse handikapi shoqëror, politik dhe mediatik ishte shumë i madh.

Pas fazës së organeve të partive politike, nis të krijohen edhe media deri diku të pavarura si 'Koha Jonë'. Me anëtarësimin e Shqipërisë në Këshillin e Evropës në korrik të vitit 1995, një erë ndryshimi nis edhe në tregun e mediave shqiptare. Ato u zhvilluan mes kaosit të vitit 1997 për të mbërritur më

---

<sup>2</sup> "Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri", Rrapo Zguri, fq. 21-22, 2017. Linku: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>

pas në vitet 2000, kur fillon të nisë një epokë e re, ajo e televizioneve private, për të arritur deri në ditët e sotme, ku shtypi pothuajse ka dalë jashtë tregut, ndërsa televizioni vijon të jetë dominues, i shoqëruar me ‘pushtimin’ e ri mediatik, atë të medias online, e quajtur ndryshe ‘portale’.<sup>3</sup>

Përgjatë këtyre 20 viteve të fundit, media është zhvilluar mes kaosit, parregullsive dhe informalitetit, duke qëndruar shumë larg standardeve të mediave perëndimore, sidomos vendeve të Bashkimit Evropian, ku vetë Shqipëria kërkon të bëhet prej vitesh anëtare me të drejta të plota. Ashtu si edhe pas viteve ’90, edhe në ditët e sotme, media është reflektim i strukturës së zhvillimit të institucioneve dhe i strukturës ekonomike të Shqipërisë. Duke filluar që nga vitet ’90, veçanërisht gjatë viteve 2000, e në vazhdim, kjo strukturë ekonomike ka prodhuar një numër të madh të gazetave në treg, rreth 24 të tilla, megjithëse vitet e fundit shumë prej tyre kanë dalë jashtë tregut apo janë mbyllur; një numër tjetër i lartë i radiove dhe televizioneve kombëtare dhe lokale. Referuar të dhënave të vitit 2018 nga Instituti Shqiptari Medias bëhet e ditur se janë dhënë

---

<sup>3</sup> Çela, E. (2015). “Media shqiptare online dhe modelet e funksionimit”, f. 6, Linku: <https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/379/02-2015-SQ-26-Erlis-Cela.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

5 licensa digjitale kombëtare, numërohen 56 stacione televizive lokale dhe 98 televizione kabllore. Ndërkaq numërohen rreth 700 portale apo media online.<sup>4</sup>

I gjithë ky numër i madh në fushën e mediave të shkruara, atyre audiovizive dhe atyre online për një popullsi prej 3 milion banorësh tregon mbingopjen dhe informalitetin ekonomik dhe shoqëror në të cilat lindin dhe zhvillohen këto media. Duke vepruar në një strukturë të tillë ekonomike, ekziston hapësira për abuzim dhe përdorimin e medias për interesa të grupeve të ndryshme, si dhe një mjedis aspak i favorshëm për ushtrimin e profesionit të gazetarit.<sup>5</sup>

Nisur nga kjo premisë dhe të dhënat e përmendura më lart tregu i medias është një treg i mbingopur gjë që vështirëson edhe pozitën ekonomike dhe sociale të gazetarëve edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare mbi këtë aspekt. Megjithatë, duhet theksuar fakti që gazetarët dhe punonjësit e tjerë të medias e ushtrojnë profesionin e tyre në një mjedis aspak të fa-

---

<sup>4</sup> ISHM. (2018). *Media shqiptare dhe standardet evropiane*, (Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës mbi Median në Demokraci), f.9, Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/Media-shqiptare-dhe-standardet-evropiane.pdf> [konsultuar më 26.11.2021]

<sup>5</sup> KAS, *Media Outlets in Albania*, Linku: <https://www.kas.de/en/web/balkanmedia/media-outlets> [konsultuar më 26.11.2021]

vorshëm teksa punojnë në orare të zgjatura, me një volum të lartë pune, me pagesa të ulëta, me vonesa të pagave, pushime nga puna, apo presione nga të më të ndryshmet.<sup>6</sup>

Nga ana tjetër, ka edhe gazetarë me përvojë të gjatë pune apo figura të njohura të gazetarisë shqiptare që paguhen mjaft mirë dhe kanë një mjedis më favorizues se reporterët e terrenit, por edhe për këtë kategori, nuk ka të dhëna zyrtare mbi pagesat e tyre përveç lajmeve që qarkullojnë në mediat online, në formën e hamendësimeve. Për ta konkretizuar në shifra problematikat e gazetarëve, gjatë një sondazhi të zhvilluar nga Instituti i Medias, “*me gazetarë dhe redaktorë, punonjësve të medias iu kërkua që të rendisnin tre problemet kryesore për profesionin e gazetarisë, dhe 61.7 për qind e tyre e vuri theksin mbi kushtet e vështira të punës dhe pasigurinë ekonomike*”.<sup>7</sup>

Vështirësitë e përmendura më lart, shtohen edhe më shumë nga fakti në Shqipëri nuk ekziston një ligj

---

<sup>6</sup> IDRA. (2019). *Tregu i punës në media*, fq. 8-9, Linku: <https://www.idracompany.com/files/ALB-Studimi%20mbi%20hendekun%20e%20aft%C3%ABsive%20n%C3%AB%20media.pdf> [konsultuar më 26.11.2021]

<sup>7</sup> ISHM, Cituar më lart, fq.34, Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/Media-shqiptare-dhe-standardet-evropiane.pdf> [konsultuar më 26.11.2021]

i posaçëm për të rregulluar të drejtat e profesionistëve të medias, por ato rregullohen vetëm përmes Kodit të Punës, ashtu si në çdo raport tjetër të punësimin në administratën publike apo në biznesin privat. Nga ana tjetër nuk ekzistojnë kritere ligjore se kush mund ta ushtrojë profesionin e gazetarit.

Ky diskutim u hodh në publik fillimisht në vitin 2001 kur po hartohej edhe projektligji për shtypin, që parashikonte krijimin e Urdhërit të Gazetarit duke ndjekur deri diku modelin italian. Por, projektligji nuk u aprovua dhe situata mbeti ajo që është. Përkundër përcaktimit apo jo të statusit të ushtrimit të profesionit të gazetarit, struktura e sistemit mediatik në Shqipëri ka sjellë si pasojë edhe një imunitet të e brishtë të gazetarëve për problemet sociale-ekonomike me të cilat përballen si dhe vendosjen e tyre në një status inferior në raportin me punëdhënësit e medias, ndryshe nga sa ndodh në vendet e Bashkimit Evropian.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Komisioni Parlamentar i Medias harton Projektligjin e ri për Shtypin (8 shkurt 2001) – *Projektligji parashikote krijimin e forumit kombëtar i gazetarëve, i quajtur “Urdhri i gazetarit” ku do të pranoheshin gazetarët me përvojë në jo më pak se 12 muaj. Ky forum do të drejtohej nga një këshill prej 7 anëtarësh me mandat 3- vjeçar të zgjedhur me votim të fshehtë.* RTV Klan: <https://www.youtube.com/watch?v=sZndhBwSf-U>

Ky raport inferioriteti midis profesionistëve të medias vjen nga fakti se si është ndërtuar modeli i biznesit mediatik në Shqipëri. Modeli i tillë mediatik është i mbështetur kryesisht nga burime të ndryshme dhe pjesa më e madhe e tyre nuk arrijnë të financohen plotësisht nga reklamat dhe në këtë mënyrë krijojnë lidhje me politikën, kryesisht njerëzit të lidhur me pushtetin apo vetë qeverinë.

Raporti i krijuar midis pronarëve të medias me qeverinë dhe politikën në përgjithësi, e vendos gazetarin në një pozitë inferiore edhe për pasojë të punojë në kushte krejt të pafavorshme duke mbajtur larg edhe Inspektoratin e Punës. Ose ky i fundit mund të konstatojë informalitetin në media, por për shkak të raportit të krijuara nga media me institucionet qeveritare, vendoset një ‘kontratë’ heshtje midis medias dhe vetë Inspektoratit. Informaliteti në ekonomi dhe në tregun mediatik ka prodhuar një situatë të tillë, ku përgjatë viteve të fundit, një pjesë e mirë e gazetarëve punojnë ‘në të zezë’ apo me kontrata formale, apo ka raste kur vitet e shumta të punës nuk janë pasqyruar te sigurimet shoqërore.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> IDRA, *Tregu i punës në media*, fq. 21, tab. 14, paragrafi 1, 2019. Linku: <https://www.idracompany.com/files/ALB-Studimi%20mbi%20hendekun%20e%20aft%C3%ABsive%20n%C3%AB%20media.pdf>

*“Rreth 23% e gazetarëve thonë se punëdhënësit nuk i paguajnë sigurimet e tyre shoqërore dhe shëndetësore. Bashkuar me 13.3% që thonë se kjo është deri diku e vërtetë, duke supozuar se kjo pagesë mund të bëhet jo në mënyrë të rregullt, shifra shkon afro 36%, ose 10% më pak se gazetarët që thonë se punëdhënësit i paguajnë këto sigurime (46.67%)”, thuhet në studimin e Komitetit të Helsinkit.<sup>10</sup>*

Kjo reflektohet edhe nga niveli i papunësisë, ku pasojat e krijuara nga pandemia kanë rritur edhe nivelin e të papunëve në vend. Sipas Institutit të Statistikave numri i të papunëve në Shqipëri u rrit me 0.2% përgjatë vitit 2020 në krahasim me vitin 2019. Po sipas INSTAT shkalla e papunësisë për popullsinë mbi 15 vjeç rezulton 11% përgjatë vitit 2020.

Ndërkaq, për vitin 2021, *“në tremujorin e parë të 2021, shkalla e punësimi për popullsinë 15-64 vjeç është 59,0 %. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2020, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 2,6 %, ndërkohë krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020, ky tregues u ul me 0,5 %. Në tremujorin e parë 2021, shkalla zyrtare e*

---

<sup>10</sup> KShH, USAID, UK Government dhe e Institutit East West Management, *Raport studimor mbi të drejtat e punës së gazetarëve*, f.33, 2020, Linku: [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf)

*papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,9 %. Sa i përket pagës, INSTAT thekson se është rritur paga mesatare bruto, ku një i punësuar në Shqipëri paguhet mesatarisht 53.662 lekë ose 2.4% më shumë se në 2019-ën”.<sup>11</sup>*

Duke iu referuar gjendjes së përgjithshme të papunësisë në vend, sipas të dhënave për vitin 2019, numri i punësuarve në media ka rënë nga 6200 në 5900 vetë *“Arsyeja kryesore lidhet me mbylljen e disa mediave, por edhe me largimet e gazetarëve nga profesioni për shkak të pakënaqësive me kushtet e punës. Raportohen shkurtime të redaksive dhe paralajmërohen mbyllje të mediave lokale, si rezultat i procesit të dixhitalizimit”<sup>12</sup>*

Sipas të dhënave të mësipërme, problemet social-ekonomike, si papunësia nga e cila vuan një pjesë e mirë e popullsisë nuk mund të përjashtojë kategorinë e profesionistëve të medias të cilët janë të detyruar të përballen me marrëdhëniet informale në punë, pasigurinë në vendin e punës punës, sidomos përgjatë vitit

---

<sup>11</sup> INSTAT, *Anketa Tremujore e Forcave të Punës*, fq.1, Qershor 2021 ([http://www.instat.gov.al/media/8492/atfp-t1-2021\\_press-release.pdf](http://www.instat.gov.al/media/8492/atfp-t1-2021_press-release.pdf))

<sup>12</sup> KSHH, USAID, UK Government dhe e Institutit East West Management, *Raport studimor mbi të drejtat e punës së gazetarëve*, fq.8, 2020 ([https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf))



2020, kur pandemia goditi mbarë botën. “Disa studime gjatë viteve 2018-2019 kanë treguar se punësimi në sektorin e medias vazhdon të mbetet problematik, për shkak të mungesës së kontratave formale të punës, vonesës së rrogave dhe pagave të ulëta.”<sup>13</sup>

Situata ndryshon edhe në varësi të vendndodhjes gjeografike të medias, apo në rastin e gazetarëve të rretheve apo kur ata punojnë edhe si korrespondentë për mediat private, për të cilat mbulojnë ngjarjet që ndodhin në qytetin apo qarkun e tyre. Një pjesë e mirë e korrespondentëve të mediave private punojnë në kushte informale, ku pagesa bëhet në raport me numri e kronikës dhe jo përmes bankës. Madje në shumicën e rasteve korrespondentët iu duhet të udhëtojnë drejt kryeqytetit për të marrë në dorë pagesën e tyre.<sup>14</sup>

Kjo ka rënduar edhe kushtet e punës në të cilët punojnë gazetarët e mediave lokale, kushte të cilat janë shumë herë më të këqija se ato të mediave në

---

<sup>13</sup> KShH, USAID, UK Government dhe e Institutit East West Management, *Raport studimor mbi të drejtat e punës së gazetarëve*, fq.8, 2020 Linku: [https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf)

<sup>14</sup> Julian Hoxhaj “Sfida e medias lokale në Shqipëri gjatë pandemisë Covid”, Fq. 2-3. Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/06/Sfida-e-medias-lokale-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-Covid-converted.pdf>

kryeqytet. Standardet e ulëta me të cilat do të duhet të punojnë gazetarët e mediave lokale nisin që nga pagesa e ulët, vonesat e pagës, siguria në punë dhe puna në kushte krejt informale, pa kontrata. Të gjendur në këto kushte mbijetese, gazetarët e mediave lokale detyrohen të kryejnë 2 ose më shumë punë, ku përveç punës si korrespondentë për mediat private, dhe punës në mediat lokale, ata punësohen edhe në bashkitë e qyteteve të tyre, duke bërë që të kompromentojnë profesionin e tyre. Nga njëra anë do të duhet të raportojnë për mediat private në Tiranë dhe ato lokale ku punojnë, nga ana tjetër do të duhet të mbrojnë imazhin e institucionit publik ku punojnë, pasi shumica janë të punësuar në zyrat e Marrëdhënieve Publike të këtyre institucioneve.<sup>15</sup>

Gjithashtu, përveç medias audiovizive apo të shkruar, media online nxjerr në pah problematika edhe më të shumta sa i përket standardeve, në të cilat zhvillohet gazetaria si profesion, raporti i gazetarëve me pronarët, informaliteti, mungesa e hierarkisë profesionale apo edhe abuzime me procesin e rekretutimit të gazetarëve. Sa i përket kësaj të fundit, shumë media

---

<sup>15</sup> Julian Hoxhaj “Sfida e medias lokale në Shqipëri gjatë pandemisë Covid”, Fq. 2, kapitulli: *Largimi i gazetarëve nga puna*. Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/06/Sfida-e-medias-lokale-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-Covid-converted.pdf> [konsultuar më 26.11.2021]

online, kryesisht portalet ‘punësojnë’ kryesisht studentë nga radhët e gazetarisë apo të fakulteteve të tjera të cilët e kanë pasion këtë profesion.

Mënyra e rekrutimit të tyre lë shumë për të dëshiruar, sepse shumica e mediave online kanë ndërtuar një praktikë të atillë ‘punësimi’, ku shumë prej studentëve iu premtohet për një kontratë pune dhe vijimin e punës në media, por pas 2 muajsh apo 3 muajsh (ku shumicën e rasteve punojnë pa pagesë apo me rroga të ulëta) atyre iu bëhet e ditur se nuk mund të vijojnë të jenë pjesë e stafit duke i larguar në mënyrë të padrejtë. Kjo praktikë ka qenë mjaft dominante në 10 vjeçarën e fundit që shënon edhe ngritjen e mediave online në Shqipëri, ndërsa vijon edhe sot, edhe pse rastet mund të jenë reduktuar. Ata punojnë gjithashtu në kushtet anonimatis, duke mos i lejuar që të mbrojnë të drejtën e autorit. Duke punuar vetëm për të mbushur portalet me lajmet e ditës, gazetarët e portaleve nuk arrijnë të krijojnë edhe një profil të tyrin profesional.

Gjithë kjo panoramë e situatës mediatike në Shqipëri dhe e pozicionit të gazetarëve duhet të bëjë, që ligjvënësi dhe organet rregullatore të angazhohen më shumë në rrugën për sigurimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të medias, e garantimit të një mjedis të sigurtë për gazetarët.





## BIBLIOGRAFIA

### Ligje

- » Ligj nr. 5506 datë 28.12.1976 “Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- » Ligji nr. 7850, 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
- » Ligji nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- » Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- » Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- » Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- » Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- » Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.
- » Ligji nr. 8239, datë 03.09.1997 “Për shtypin”, i ndryshuar.
- » Ligji nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- » Ligji shfuqizues nr. 7553, datë 30.1.1992.
- » Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore Kushtetuese”.
- » Kushtetuta e Republikës Popullore të Shqipërisë, 5 korrik 1950
- » Ligji nr. 1470, datë 23.5.1952 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- » Ligji nr. 5591, datë 15.6.1977 “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- » Ligja “Mbi shtypin”, datë 24.01.1931.

### **Konventa ndërkombëtare dhe rezoluta**

- » <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Safety-OfJournalists/Pages/resolutions.aspx>
- » <https://undocs.org/A/HRC/RES/21/12>
- » <https://undocs.org/en/A/RES/68/163>

- » <https://undocs.org/en/A/RES/69/185>
- » <https://undocs.org/en/A/HRC/RES/45/18>
- » [https://www.echr.coe.int/Documents/Convention\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.pdf)
- » [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0wsU/content/recommendation-no-r-2000-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-right-of-journalists-not-to-disclose-their-sources-of-information?inheritRedirect=false](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0wsU/content/recommendation-no-r-2000-7-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-the-right-of-journalists-not-to-disclose-their-sources-of-information?inheritRedirect=false) [konsultuar më 26.11.2021]
- » [https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset\\_publisher/aDXmrol0wsU/content/recommendation-cm-rec-2013-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-gender-equality-and-media-adopted-by-the-committee-of-ministers-on-10-j?\\_101\\_INSTANCE\\_aDXmrol0wsU\\_viewMode=view/](https://www.coe.int/en/web/freedom-expression/committee-of-ministers-adopted-texts/-/asset_publisher/aDXmrol0wsU/content/recommendation-cm-rec-2013-1-of-the-committee-of-ministers-to-member-states-on-gender-equality-and-media-adopted-by-the-committee-of-ministers-on-10-j?_101_INSTANCE_aDXmrol0wsU_viewMode=view/) [konsultuar më 26.11.2021]
- » [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#\\_ftn1](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806415d9#_ftn1)
- » <https://rm.coe.int/leaflet-media-freedom-en/16808b53e4> [konsultuar më 26.11.2021]

- » <https://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-554214-Press-freedom-in-the-EU-FINAL.pdf> [konsultuar më 23.11.2021].
- » Traktati i Lisbonës, neni 6 (1).
- » Direktiva 2021/13/EU, datë 10.03.2010.
- » <https://www.europarl.europa.eu/EPRS/EPRS-Briefing-554214-Press-freedom-in-the-EU-FINAL.pdf> p. 5.
- » [https://erga-online.eu/?page\\_id=7](https://erga-online.eu/?page_id=7) [konsultuar më. 25.11.2021]
- » <https://www.osce.org/files/mcdec0003%20safety%20of%20journalists%20en.pdf>

### Vendime gjyqësore

- » Gjykata Kushtetuese vendimi nr. 56/2016.
- » *Observer dhe Guardian Newspapers k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13585/88, datw 26 nwn-tor 1991.
- » *Goodwin k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 28957/95, datë 11 korrik 2002.
- » *Dink k. Turqisë*, nr. 2668/07, 6102/08, 30079/08, datw 14 shtator 2010.
- » *Shkullaku dhe të Tjerët k. Shqipërisë*, kërkesa nr. 20204/21.



## Botime dhe artikuj

- » (...) Article 19. (2007). *Liria e shprehjes: standartet ndërkombëtare*. Tiranë: QSHDI.
- » Bianku, L. (2020). *Drejt praktikës: përdorimi i jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut në nivel vendas*. Tiranë: Qendra Europiane.
- » Darbshire, H. (1997, May). Data Protection and Freedom of Information, “Access to information and the media”, Budapest, Hungarian Civil Liberties Union.
- » Darbshire, H. et. Al. (1999). *Media and democracy*. Strasbourg: Council of Europe.
- » <https://www.freedomforuminstitute.org/about/faq/what-is-freedom-of-expression/> [konsultuar më 17.03.2021].
- » Malltezi, A. (2011). *E drejta shqiptare e shoqërive tregtare*, Tiranë: Media print.
- » Mole, N. & Kamber, k. & Liaki, V. (2018). *Drejt një Zbatimi Efektiv në Nivel Kombëtar të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Londër: AIRE Centre.
- » Omari, L. & Anastasi, A. (2017). *E drejta Kushtetuese*. Tiranë: Dajti 2000.
- » Petrela, I. & Kodra, K. (2017). *E drejta për informim dhe liria e shprehjes: manual*. Tiranë: Qendra Europiane & KAS.

- » Siniarska-Bychawska, D. (2018). Mbrojtja e të drejtës për lirinë e shprehjes sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut: manual për praktikantët e ligjit, Tiranë: Onufri.
- » Bebja, A. (2017). *Studim i rrallë dhe i veçantë francez mbi shtypin shqiptar 1848-1939*. <https://telegrafi.com/studim-rralle-francez-per-shtypin-shqiptar-te-viteve-1848-1939/> [konsultuar më 17.03.2021].
- » <http://albania.mon-rsf.org/sq/konteksti/historia> [konsultuar më 17.03.2021].
- » <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit> [konsultuar më 15.07.2021].
- » <https://tpz.al/mos-perhapni-panik-per-qellime-politike-zv-ministrja-e-shendetesise-karantina-per-koronavirusin-ploteson-standartet>
- » <https://www.britannica.com/topic/media-freedom> [konsultuar më 17.03.2021].
- » G20/OECD Principles of Corporate Governance, 2015 <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264236882-en.pdf?expires=1638553664&id=id&accname=guest&checksum=2D10E8035CF44A0DB0308485705531B8> [konsultuar më 20.11.2021].

- » Reporter.al, *Fushata virtuale; mbulimi nga media online anon në favor të PS-së*. Linku: <https://www.reporter.al/fushata-virtuale-mbulimi-nga-media-online-anon-ne-favor-te-ps-se/>
- » Zguri, Rr. *Marrëdhëniet mes medias dhe politikës në Shqipëri*, 2017. <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14000.pdf>
- » Gazeta ‘Panorama’, 27 korrik 2015, “Zyrtarizohen akuzat për Becchetti-n: Pastrim parash dhe krijim të skemave mashtruese”. Linku: <http://www.panorama.com.al/prokuroria-zyrtarizon-akuzat-per-becchetti-n-pastrim-parash-dhe-krijim-te-skemave-mashtruese/>
- » Gazeta ‘Mapo’, 21 korrik 2021. “Unë fitova”/ Becchetti në aksion për 110 mln €, Denaj: Do ta paguajmë <https://gazetamapo.al/une-fitova-becchetti-ne-aksion-per-110-mln-e-denaj-do-ta-paguajme/>
- » Albania 2020 Human Rights Report, link: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/03/ALBANIA-2020-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>
- » Raporti i Freedom House për vitin 2020, linku: [https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4\\_u30q7pu](https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2021#footnote4_u30q7pu) [konsultuar më 22.11.2021]

- » <https://www.reporter.al/gazetarja-alice-taylor-fiton-betejen-8-mujore-me-police-e-shtetit/>
- » *Televizionet, gazetat e portalet online “në shërbim” të Bashkisë Tiranë*. Linku: <https://www.medialook.al/televizionet-gazetat-dhe-portalet-online-ne-sherbim-te-bashkise-tirane/> [konsultuar më 22.11.2021]
- » DW – “Shqipëri: Paketa ligjore Anti-Shpifje sërish në qendër të debatit”. Linku: <https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-paketa-ligjore-anti-shpifje-s%C3%ABrish-n%C3%AB-qend%C3%ABr-t%C3%AB-debatit/a-54985644> [konsultuar më 22.11.2021]
- » “A German company is responsible for the deletion of videos critical of the Albanian government” NetzPolitik.org 19 March 2020. Linku: <https://netzpolitik.org/2020/a-german-company-is-responsible-for-the-deletion-of-videos-critical-of-the-albanian-government/>
- » Instituti Shqiptar i Medias - Tregu i reklamave në median shqiptare – fq. 13-14. Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/01/Tregu-i-Reklamave-ne-Median-Shqiptare.pdf> [konsultuar më 22.11.2021]
- » Reporter.al – Rama përshkallëzon “luftën” e tij kundër medias në telefonat celularë

- <https://www.reporter.al/rama-pershkallezon-luften-e-tij-kunder-medias-ne-telefon-at-celulare/>
- » Zëri i Amerikës. *Shqipëri, pronarët e mediave me lidhje të forta politike*. Linku: <https://www.zeriamerikes.com/a/4296220.html>
  - » Qendra MediaLook, AMA “e pafuqishme” ndaj TV-ve, lejon kronikat “reklamë” në edicionet informative. Linku: <https://www.medialook.al/ama-e-pafuqishme-ndaj-tv-ve-lejon-kronikat-reklame-ne-edicionet-informative/>
  - » AMA, Raporti Vjetor 2017, linku: <https://www.medialook.al/wp-content/uploads/2019/02/Raporti-vjetor-AMA-2017.pdf>
  - » AMA, Raporti Vjetor 2020, linku: [http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-Vjetor-i-AMA\\_2020.pdf](http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-Vjetor-i-AMA_2020.pdf)
  - » <https://www.refworld.org/docid/3b00f0975f.html> [konsultuar më 20.11.2021].
  - » “Shtypi komunist si një element i rëndësishëm në propagandën ateiste në regjimin totalitar shqiptar 1960-1970”, Sokol Paja, <https://aab-edu.net/wp-content/uploads/2020/02/02-2015-SQ-20-Sokol-Paja-1.pdf>
  - » Çela , E. (2015). “*Media shqiptare online dhe modelet e funksionimit*”, Linku: <https://>

dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/379/02-2015-SQ-26-Erlis-Ce-la.pdf?sequence=1&isAllowed=y

- » ISHM. (2018). *Media shqiptare dhe standardet evropiane*, (Raport i bazuar mbi Treguesit e Këshillit të Evropës mbi Median në Demokraci), Linku: <http://www.institutemedia.org/wp-content/uploads/2020/05/Media-shqiptare-dhe-standardet-evropiane.pdf> [konsultuar më 26.11.2021]
- » KAS, *Media Outlets in Albania*, Linku: <https://www.kas.de/en/web/balkanmedia/media-outlets> [konsultuar më 26.11.2021]
- » INSTAT, *Anketa Tremujore e Forcave të Punës, Qershor 2021* ([http://www.instat.gov.al/media/8492/atfp-t1-2021\\_press-release.pdf](http://www.instat.gov.al/media/8492/atfp-t1-2021_press-release.pdf))
- » KShH, USAID, UK Government dhe e Institutit East West Management, *Raport studimor mbi të drejtat e punës së gazetareve, 2020* ([https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor\\_Te-drejta-pune-per-gazetaret\\_ALB-1.pdf](https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/06/Raport-Studimor_Te-drejta-pune-per-gazetaret_ALB-1.pdf))
- » Hoxhaj, J. “Sfida e medias lokale në Shqipëri gjatë pandemisë Covid” Linku:

n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-gjat%C3%AB-pandemis%C3%AB-Covid-converted.pdf

- » IDRA, Tregu i punës në media. Linku: <https://www.idracompany.com/files/ALB->
- » Studimi%20mbi%20hendekun%20e%20af-t%C3%ABsive%20n%C3%AB%20media.pdf [konsultuar më 26.11.2021]

